



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar)

“Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë” (MIE)

Shtator, 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (*Auditim Financiar*)

“Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)”

<u>Nr.</u>	<u>Përmbajtja</u>	<u>Faqe</u>
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3-5
II	OPINIONI I AUDITIMIT	6-8
III	HYRJA	9-13
	1. Objektivat dhe qëllimi.....	
	2. Identifikimi i çështjes.....	
	3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	4. Përgjegjësitë e audituesve.....	
	5. Kriteret e vlerësimit.....	
	6. Standardet e auditimit.....	
IV	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13-62
V	GJETJET DHE REKOMANDIMET SIPAS DREJTIMEVE TE ANGAZHIMIT	63-73
VII	ANEKSE	74-75



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Informacioni i përgjithshëm

Kontabiliteti në sektorin publik mbështetet në këto parime bazë:

- Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, për një të ardhme të parashikueshme.
- Të dhënat që përmbajnë pasqyrat financiare duhet të jenë të kuptueshme për përdoruesit, të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për veprimtaritë ekonomike të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe për kontabilitetin.
- Të dhënat për elementet dhe për shumat që ndikojnë në vendimmarrjet ekonomike të përdoruesve paraqiten veçmas në pasqyrat financiare.
- Kompensimi ndërmjet një elementi të aktivitetit të bilancit dhe një elementi të detyrimeve, si dhe ndërmjet një të ardhure dhe një shpenzimi është i ndaluar, përveç rastit kur parashikohet ose autorizohet nga një standard kontabël.
- Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.
- Pasqyrat financiare duhet t'u japin mundësi përdoruesve që të bëjnë krahasime ndërmjet ushtrimeve të ndryshme kontabël ose njësisë të qeverisjes së përgjithshme të ndryshme.

Organizimi dhe funksionimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë rregullohet me vendimin nr. 504, datë 13.9.2017 të Këshilli të Ministrave, i cili ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë shtetërore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Ky institucion ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energetike e minerare dhe në sektorin e industrisë.

Auditimi financiar mbi baze sistemi është me fokus të përcaktuar mbi hartimin e pasqyrave individuale vjetore dhe konsolidimin e tyre në nivel grupi nga ana e institucionit qendror Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- *Objekt i këtij auditimi* është: Vlerësimi nëse kuadri ligjor në fuqi në fushën e kontabilitetit publik është i plotë dhe i zbatueshëm, se përputhet me IPSAS; nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara nga IB (institucionet buxhetore) dhe ML (ministrinë e linjës administrative) janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi kontabilitetin dhe raportim financiar. Në përfundim të këtij angazhimi auditimi sigurdhënie, **do të jepet përgjigje pyetjes: nëse janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara për sektorin publik në Shqipëri për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022.**

- *Qëllimi i auditimit:* Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, *nëpërmjet shprehjes së një opinioni/konkluzioni (sipas rastit) nga ana jonë nëse pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare*

- *Fushëveprimi i auditimit:* Vlerësimi i zbatimit të kuadrit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik, me qëllim dhënien e opinionit/ konkluzionit, shtrirë sipas drejtimeve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

programit të auditimit. Janë audituar me zgjedhje dhe në mënyrë të njëpasnjëshme dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin/ subjektet që kanë për periudhën 01.01.2021-31.12.2022, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje dosjet sipas programit për periudhën objekt auditimi.

1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. **360/4, datë 13.04.2023** në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Tiranë, nga data 20.4.2023 – 14.07.2023, për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2022, ushtroi auditimin në këtë institucion “Mbi auditimin financiar mbi bazë sistemi”, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në fushë e kontabilitetit dhe raportimit financiar publik, zbatimin e teknikave dhe parimeve në mbajtjen e evidencës kontabile dhe respektimin e kriteve për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore individuale e të konsoliduara nga organet e qeverisjes qendrore e vendore dhe nga ana e MIE, etj.

1.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	REFERENCA ME RPA	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
I.	<p><i>Për periudhën objekt auditimit, rezultojnë se në 10 raste, institucionet buxhetore të analizuar, kanë shfaqur probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale, nga institucionet buxhetore dhe ekstra-buxhetore, dhe më konkretisht:</i></p> <p><i>Për vitin 2021, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore MIE, ose afro 33 % e tyre, kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, me tejkalim dhe shkelje të afatit ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, përkatësisht, këto institucione për v.2021:</i></p> <p><i>Për vitin 2022, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore MIE, ose afro 33 % e tyre, kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore, pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, në institucionet e mëposhtme për v.2022:</i></p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga ana e strukturave përgjegjëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të merren masat për zbatimin me përpikmëri të afateve kohore të përcaktuara në kuadrin rregullator mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar, duke administruar, sipas afateve ligjore të miratuara, pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, individuale dhe përmbledhëse nga të gjithë institucionet e sektorit publik të varësisë direkte.
II.	<p><i>Mos përfshirja në setin e pasqyrave të konsoliduara e të gjitha institucioneve që shtrihen brenda fushës së përgjegjësisë së Ministrisë, të kërkuara sipas kuadrit ligjor.</i></p> <p>Nuk janë përfshirë në pasqyrat e konsoliduara, të dhënat e institucionit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), pasi në Nenin 3 “Përkufizime”, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nënvizohet se, “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)” është institucion me përgjegjësi planifikimi në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit” si dhe më tej në Nenin 8 “Përgjegjësitë e ministrisë së linjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të po këtij ligji.</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të saktësojnë numrin e institucioneve shpenzuese buxhetore dhe ekstra-buxhetore, që kanë detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore, me qëllimin e konsolidimit financiar e kontabël, si dhe përmbledhjen e informacionit financiar të organit qendror të njësisë (aparati), me të gjitha njësitë e varësisë/ institucionet shpenzuese dhe kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore MIE.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

III.	<p>Nuk është regjistruar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të periudhës 2021- 2022 vlera e trojeve në administrim të institucionit, të cilat ndikojnë në cilësinë e kontabilitetit dhe pasqyrimin me vërtetësi e saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël në shumë institucione publike. Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2021, llogaria nr. 210 "Toka, troje e terrene" është në vlerën zero lekë dhe nuk janë regjistruar këto sipërfaqe toke në kontabilitetin e njëjësive shpenzuese buxhetore, ndonëse sipas VKM përkatëse, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objekteve ndërtimore dhe truallit, për llogari të këtyre institucioneve.</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Të merren masat nga NA dhe NZ i MIE, që të kërkojnë nga Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të njëjësive shpenzuese, buxhetore e ekstra-buxhetore dhe Degët e Thesarit sipas juridiksionit dhe të marrin masa për vlerësimin, regjistrimin dhe evidentimin e saktë të gjendjes së llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" në kontabilitet, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vlera e tokës truall nën objektet e ndërtesave të pasqyruara në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione", si dhe vlera e trojeve dhe terreneve, të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave u janë kaluar në pronësi të institucioneve shtetërore, etj.
IV.	<p>Teprica debitore e Llog.486 "Shpenzimet e periudhave të ardhshme", sipas PFK të MIE për vitin 2021 është evidentuar (për ushtrimin e mbyllur me dt.31.12.2021) në vlerën 1,966,810,355 lekë, shumë kjo e mbartur me korrektesë në çelje të PFK të vitit 2022, dhe për vitin 2022 teprica e kësaj llogarie është 542,573,164 lekë. <u>Pra, nuk rezultojnë të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 468.</u> Sa më sipër, analiza e pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) tregon se, për vitin 2020, 2021 dhe 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në shumicën e institucioneve buxhetore të vartësisë, nuk janë hartuar në përputhje me përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022.</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Ministria e Infrastrukturrës dhe Energjisë të marrë masa për të monitoruar zbatimin e normave teknike dhe ndjekë procesin e sistemeve në kontabilitet të llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" në kundërt parti në saj, llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për pasqyrat financiare të ushtrimit që do të mbyllet më 31.12.2023, meqenëse llogaria 486 si llogari e pozicionit financiar luan rolin e një llogarie teknike për identifikimin e detyrimeve të prapambetura.
V.	<p>a. Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar nga VKM dhe kaluar në përgjegjësi administrimi të ministrisë dhe subjekteve të varësisë direkte;</p> <p>b. Përfshirja e vlerës e planeve të përgjithshme vendore, pjesë e llog.202 "Studime dhe kërkime", në vlerën 1,345,048,518 lekë, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	MIE, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për saktësimin e analizës së llogarive dhe të bëjnë korrigjimet dhe sistemitet e domosdoshme, që në këtë llogari të aktiveve afatgjata materiale të paraqitet vlera e drejtë e tyre dhe e rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël. Nga ana e MIE gjatë vitit 2021 të merren masat për transferimin e vlerës së planeve të përgjithshme vendore, kontabilizuar në llog.202 "Studime dhe kërkime", prej 1,345,048,518 lekë , e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, që në fakt i përkasin zërave, të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabël të Aparatit të MIE, por e bashkive respektive.
VI.	<p>Nga auditimi i llogarisë 230 konstatohet se për vlerën prej 34,145,203 lekë nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj (gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Energjetikës), si dhe mungon analiza për këtë vlerë dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këtë aktiv. Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 231 konstatohet se për dy aktive në vlerë 2,804,028,855 lekë mungon analiza e tyre dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këto aktive, pasi për aktivin në vlerën prej 269,377,038 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish-Ministria e Transportit dhe për aktivin në vlerë 2,534,651,817 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish-Ministria e Energjisë.</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga ana e MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim identifikimin e analizës së llogarisë 230 dhe 231 që përfaqësojnë shumën e regjistruar në kontabilitet me emërtimin "ish Ministria e Transportit" dhe "ish Ministrisë së Energjetikës", etj., në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të plotë vërtetues dhe të behet transferimi i tyre në llogaritë kontabël përkatëse.
VII.	<p>Evidentohet një nivel i lartë i detyrimeve të subjekteve debitore dhe klientëve dhe që ka patur trend në rritje për periudhën e audituar. Debitorët e ndryshëm (llog. 468) ishin në shumën prej 2,043 milionë lekë në vitin 2020, 4,209 milionë lekë në vitin 2021 dhe 4,694 milionë lekë në fund të v. 2022.</p> <p>Rezultoni se janë shtuar edhe të drejtat e tjera për arkëtim, të tilla si "Divident i Albpetrolit" për 2,155,452,687 lekë, (për të cilin janë arkëtuar vetëm 1 milionë lekë); masa e dëmit sipas urdhrin nr.313. datë 23.12.2020 "Për përfundimet e inspektimit financiar publik" për 7 zyrtarë, me nga 126,322 lekë/secili, etj.</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Drejtuësit e MIE të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë dhe të marrin masat, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët pasi teprica e tyre ka arritur 4,694 milionë lekë në fund të v.2022 si dhe për shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni kundrejt të tretëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

1.3. OPINIONI I AUDITIMIT:

I.Opinionit për auditimin financiar¹: i kualifikuar²:

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të MIE, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 dhe 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinionit:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrin rregullator në fuqi: Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

Nga auditimi financiar, mbështetur në, ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar” dhe ISSAI 2000 “Aplikimi i Standardeve të Auditimit Financiar”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, nën gjykimin tonë, kontabiliteti dhe pasqyrat financiare të institucionit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në përgjithësi, në të gjitha aspektet materiale, janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Megjithatë, nga auditimi financiar rezultuan edhe anomali e parregullsi apo raste të shkeljeve të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, të konsideruara *materiale* dhe *jo të përhapura*, në llogaritë vjetore individuale e të konsoliduara në nivel grupi apo në transaksionet në fjalë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **“Opinionit të Kualifikuar” të auditimit.**

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionin e qeverisjes qendrore Ministria e

1 - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

2 -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3.5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Infrastrukturës dhe Energjisë dhe subjektet e varësisë së saj, sipas kërkesave të legjislacionit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuar si më poshtë vijon:

- Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë hartuar Pasqyrat Financiare Përmbledhëse Vjetore për v.2021 dhe 2022, por ato përmbajnë parregullsi, mangësi e mospërputhje, ndaj nuk është e mundur që të ofrohet siguri e plotë mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit të përmbledhur në nivel grupi (ministrie).
- Për periudhën objekt auditimit, rezulton se në **10 raste**, institucionet buxhetore të analizuar, kanë shfaqur probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale, nga institucionet buxhetore dhe ekstra-buxhetore. Njësitë e Zbatimit të Projekteve të MIE nuk kanë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë MIE dhe MFE-së për v.2021 dhe 2022..Nuk janë përfshirë në pasqyrat e konsoliduara, të dhënat e institucionit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT). Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë” dhe “Agjencisë Kombëtare Bërthamore Tiranë” nuk janë dorëzuar PFK të vitit 2022.
- Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2021, llogaria nr. 210 “Toka, troje e terrene” është në vlerën **zero lekë** dhe nuk janë regjistruar këto sipërfaqe toke në kontabilitetin e njërive shpenzuese buxhetore, ndonëse sipas VKM përkatëse, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objekteve ndërtimore dhe truallit, për llogari të këtyre institucioneve.
- Teprica debitore e llog.486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme”, sipas PFK të MIE për vitin 2021 është evidentuar (për ushtrimin e mbyllur me dt.31.12.2021) në vlerën **1,966,810,355 lekë**, shumë kjo e mbartur në çelje të PFK të vitit 2022, dhe për vitin 2022 teprica e kësaj llogarie është **542,573,164 lekë**. Pra, nuk rezulton të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 486. Sa më sipër, analiza e pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) tregon se, për vitin 2020, 2021 dhe 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në shumicën e institucioneve buxhetore të varësisë, nuk janë hartuar në përputhje me përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022.
- Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar nga VKM dhe kaluar në përgjegjësi administrimi të ministrisë dhe subjekteve të varësisë direkte; Përfshirja e vlerës e Planeve të Përgjithshme Vendore, pjesë e llog.202 “Studime dhe kërkime” të MIE, në vlerën **1,345,048,518 lekë**, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore.
- Nga auditimi i llogarisë 230 konstatohet se për vlerën prej **34,145,203 lekë** nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj (gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Energjetikës), mungon analiza inventariale për këtë vlerë dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këtë aktiv. Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 231 konstatohet se për 2 (dy) aktive në vlerë **2,804,028,855 lekë** mungon analiza e tyre dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këto aktive, pasi për aktivin në vlerën prej 269,377,038 lekë është vendosur shënimi “Gjendje nga vitet e kaluara, ish-Ministria e Transportit” dhe për aktivin në vlerë 2,534,651,817 lekë është vendosur shënimi “Gjendje nga vitet e kaluara, ish-Ministria e Energjisë”.
- Evidentohet një nivel i lartë i detyrimeve të subjekteve debitore dhe klientëve dhe rezulton një trend në rritje për to për periudhën e audituar. Llogaria “Debitorë të ndryshëm” (llog. 468) pasqyrohet në shumën prej **2,043 milionë lekë** në vitin 2020, **4,209 milionë lekë** në vitin 2021 dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

4,694 milionë lekë në fund të v. 2022. Evidentohet se, janë shtuar të drejtat e tjera për arkëtim, për zëra të tilla si **“Divident i Albpetrolit”** për **2,155,452,687 lekë, (nga kjo shumë janë arkëtuar vetëm 1 milionë lekë);** masa e dëmit sipas urdhrit nr.313. datë 23.12.20202 “Për përfundimet e inspektimit financiar publik” për 7 zyrtarë të institucionit, me nga 126,322 lekë/secili.

- Për vitin ushtrimor 2022 janë shtuar detyrimet debitore në kuadër të Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, për **OSHEE Grup sha**, për detyrimet e tarifës koncesionare, sipas kontratës koncesionare nr.5535/5, datë 24.10.2016 në shumën **1,495,990,439 lekë**. Përfshirja e detyrimeve të OSHEE Grup sha, për sa llogaritur tarifa koncesionare e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et të dhëna me koncesion për periudhën 2016-2021, i përket një periudhe 5 vjeçare, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në kontabilitet.

- Ekzistojnë mospërputhje midis të dhënave të bilancit të konsoliduar të MIE, i mbyllur më datën 31.12.2022, (sa pasqyruar në formatin 7/b, krahasuar me të dhënat e regjistruara në Formatin nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël për AAM). Më konkretisht, *Aktivet Afatgjata Materiale më dt. 31.12.2022 në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) janë pasqyruar për 182,171,229 mijë lekë dhe në Pasqyrën e Aktiveve “Gjendja dhe ndryshimi aktiveve afatgjata F7 janë 182,163,506 mijë dhe paraqesin diferencën ose nuk rakordojnë prej 7,723 mijë lekë.*

- Mos rakordim i të dhënave dhe vlerave të bilancit të konsoliduar të MIE në rubrikën “ushtrimi i mbyllur” (të datës 31.12.2021) evidentuar **391,217,673,910 lekë**, me të dhënat e rubrikës “ushtrimi paraardhës”, (të bilancit të datës 31.12.2022) pasqyruar **391,212,997,609 lekë**, për diferencën prej **4,676,301 lekë**, në kundërshtim me paragrafin 31, pika 3.1,”Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.

Bazuar në konkluzionet kryesore të raportit të auditimit, KLSH nënvizon domosdoshmërinë, për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të MIE, nga njëra anë, por edhe të titullarëve të subjekteve publike të varësisë së kësaj ministrie, nga ana tjetër, për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat e identifikuar. Është e nevojshme që të instalohen mekanizma, të cilët sigurojnë zbatimin e parimeve, rregullave dhe standardeve të kontabilitetit të sektorit publik, por edhe rishikimit e forcimit të strukturave organike, sanksioneve e masave ndëshkuese, pasi një numër i gjetjeve mbi parregullsitë e fushës së kontabilitetit dhe raportimit financiar, vijnë të përsëriten nga viti në vit, siç prezantohen në raportet e auditimit të KLSH në subjektet e audituara.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit

Strukturat menaxheriale të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësia e audituesve të KLSH për auditimin financiar.

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare, bazuar mbi rezultatet e auditimit. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. nr.360/4 datë 13.04.2023 “Mbi auditimin Financiar mbi baze sistemi pranë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Tiranë”, nga data 20.04.2023 – 14.07.2023, për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2022, u krye Auditimi Financiar mbi bazë sistemi, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Q. C, (përgjegjës grupi),
2. A. Z, anëtar
3. G. G, anëtar
4. A. M, anëtar.

1. Titulli:

Raport Përfundimtar i Auditimit Financiar mbi bazë sistemi në MIE.

2. Marrësi:

Ky Projekt raport i adresohet Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Znj. B. B.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit Auditimi financiar synon dhënien e një vlerësimi të pavarur, që rezulton në një konkluzion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejte dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar, Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare do të jene:

-Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara nga ministria për aparatit dhe subjektet e varësisë direkte të saj janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar, etj.

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si;

ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-saktësia dhe plotësia e informacionit kontabël mbi raportimin financiar dhe hartimi i pasqyrave të konsoliduara për sistemin e qeverisjes së përgjithshme.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si;

transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

4. Identifikimi i çështjes: Qëllimi i auditimit me fokus të përcaktuar mbi hartimin e pasqyrave individuale vjetore dhe konsolidimin e tyre në nivel grupi nga ana e institucionit qendror Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, (MIE).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 360, datë 13.04.2023.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Niveli menaxherial i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

6. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare, bazuar mbi rezultatet e auditimit. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin e grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë.

7. Kriteret e vlerësimit:

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

<i>Lloji i dokumentit</i>	<i>Detajet e bazës ligjore dhe rregullatorë</i>
Ligje:	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”;- Ligji nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH”, i ndryshuar;- Ligji nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";- Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";- Etj.
VKM:	<ul style="list-style-type: none">- VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve te prapambetura e te plan-veprimi”.
Udhëzime:	<ul style="list-style-type: none">- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e te pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes se Përgjithshme", i ndryshuar;- Udhëzimi MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut te detyrimeve te prapambetura te qeverisjes se përgjithshme”;- Udhëzimi i Ministrisë se Financave nr. 30, date 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësite e sektorit publik";- Udhëzimet standard te Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Rregullore:	<ul style="list-style-type: none">- Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH-e", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSHS nr.197, date 12.10.2022;- Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 63, date 22.6.2020, të Kryetarit të KLSH' e ndryshuar.
--------------------	---

8. Standardet e auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Kërkesat e " Udhërrëfyesit të IDI, INTOSAI " Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit";
- Standardet Kombëtare të kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH.

9. Metodatat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

K kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese për të konstatuar nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

K kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Intervistimi.

6. Raporte dhe Informacione.

10. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

- Nga ana e institucionit të KLSH është dërguar Projekt Raporti i Auditimit në Ministrinë e Infrastruktures dhe Energjisë, me shkresën nr. 360/8, datë 31.07.2023.
- Nga ana e strukturave të MIE, janë komentet dhe objeksionet e në lidhje me PRA me shkresën e MIE me nr 6406/1 prot., datë 04.09.2023, protokolluar në KLSH me nr.360/10, datë 06.09.2023, të cilët janë shqyrtuar dhe trajtuar nga grupi i auditimit dhe përfshirë në këtë raport përfundimtar të auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

III. DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Auditimi i sistemit të raportimit financiar dhe llogaridhënies vjetore për vitin 2021 dhe 2022.

Auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë së plotësisimit të pasqyrave financiare të institucioneve përkatëse dhe atyre të konsoliduara. Vlerësimi nëse zërat e aktivitetit dhe pasivit të bilancit janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe ndërlidhja me dokumentacionin justifikues. Inventarizimi i pronës shtetërore.

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Mbajtja e kontabilitetit dhe procedurat e mbylljes së llogarive vjetore (individuale dhe përmbledhëse), në institucionin e MIE për vitin 2021 dhe 2022 janë mbështetur në kriteret e vendosura në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

MIE është njësi shpenzuese me kontabilitet më vete. Mbajtja e dokumentacionit justifikues nga ky institucion dhe nga subjektet e varësisë që kanë depozituar pasqyrat financiare vjetore në këtë institucion të qeverisjes qendrore, si dhe regjistrimet e veprimeve kontabile, në përgjithësi janë kryer mbështetur në dokumentacionin justifikues, në frymën e parimeve të përgjithshme dhe rregullave për përgatitjen e pasqyrave financiare, llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Kontabiliteti i njësisë shpenzuese mbahet me Excel, ku janë regjistruar veprimet kontabile në ditarët përkatës kontabël.

Nga auditimi rezulton se, Pasqyrat Financiare të institucionit janë të shoqëruara me inventarin e llogarive, me situacionin dhe aktet e rakordimit, të hartuara mbi realizimin e buxhetit vjetor, dokumente këto të firmosura/konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë. Bilanci i aparatit të MIE si dhe Bilanci Përmbledhës, janë përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për secilin vit objekt auditimit. Nga verifikimi i pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore rezulton se, janë mbajtur ditarët për regjistrimin e veprimeve kontabile si dhe llogaritë e Aktivitetit dhe të Pasivit, (pjesë e formatit nr.1, Pasqyra e Pozicionit Financiar), kuadrojnë si shumë totale dhe se në përgjithësi, llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, trajtuar më hollësisht në vijim.

Nga auditimi financiar mbi bazë sistemi, i kryer në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe në disa njësi të tjera shpenzuese të varësisë, si dhe njësi të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me financim të huaj, dhe kryqëzimi i të dhënave dhe informacioneve, evidentohet se, kuadri nënligjor bazë mbi përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin për çdo vit kalendarik të mbyllur më 31 dhjetor të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore, ka përcaktuar këto afate të detyrueshme për zbatim:

- Pasqyrat financiare në nivel të Njësisë Ekonomike, hartohen brenda **31 Marsit të vitit pasardhës**; (në referim të paragrafit nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i cili nuk ka ndryshim mbi këto afate dhe përcaktime):

117.Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit;

*118. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur **brenda muajit Mars të vitit pasardhës**. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit;*

*119. Njësitë e menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj detyrohen të depozitojnë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor të mbyllur **brenda muajit Mars të vitit pasardhës**, duke dërguar një kopje pranë ministrisë apo institucionit publik që menaxhon projektin, një kopje pranë donatorit/rëve përkatës dhe një kopje e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;*

*121. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, të cilat nuk kanë në varësi institucione apo njësi shpenzuese me kontabilitet më vete, **brenda muajit Mars të vitit pasardhës** depozitojnë pasqyrat financiare të tyre, duke dërguar një kopje në degën e thesarit dhe pas konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje e dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;*

- Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në nivel të grupit (Ministri dhe institucione qendrore) hartohen **brenda 30 prillit të vitit pasardhës dhe depozitohen në DPTH të MFE (në referim të paragrafit nr.23, të UMF nr.5, datë 21.2.2022)**;

- Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar për pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të sapo mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, **brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**. Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisë dhe në rast mos akordimi i kthehet njësisë publike qendrore (organit qendror të saj) për zhurmim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njëzia qendrore.

- Pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel të grupit (Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore) hartohen **brenda 30 prillit të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në DPTH të MFE (në referim të paragrafit nr.24, të UMF nr 5, datë 21.2.2022)**;

-MFE-ja nxjerr dhe dorëzon raportin e konsoliduar të buxhetit për sektorin e qeverisjes së përgjithshme për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda **fundit të majit të vitit pasardhës**.

Paragrafi nr. 20, i UMF nr.5, datë 21.2.2022 ka parashikuar që: Në Kapitullin IV "Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara", (të UMFE nr. 8, datë 9.3.2018), paragrafi 101 ndryshon si më poshtë vijon:

“Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (*duke bërë eliminimet dhe mënjeluar dublimet*) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

- a) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Njësie Publike Qendrore, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (*aparati*), ***të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore;***
- b) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Njësie Publike të Vetëqeverisjes Vendore, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (*aparati*), ***të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike vendore;***
- c) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Qeverisje Qendrore përfshirë ***të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve)***, informacionin e Llogarisë qendrore të qeverisë, të Llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.
- d) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Qeverisje Vendore, përfshirë ***të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe këshillat e qarqeve)***.
- e) Konsolidim i pasqyrave financiare në nivel Qeverisje të Përgjithshme, përfshirë pasqyrat e konsoliduara sipas pikës c dhe d.”

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në të cilat paraqiten aktivet, detyrimet, aktivet neto/kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të njësisë kontrolluese dhe të njësive të kontrolluara, si të ishin të një njësie të vetme ekonomike.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MIE, del se:

- ***Numri total i institucioneve shpenzuese, që janë përfshirë në konsolidim nga ana e MIE, për vitin 2021, është 15 njësi/institucione publike, (duke përfshirë dhe aparatit e MIE), nga të cilat 15 institucione buxhetore, 0 ekstra-buxhetore, 0 njësi të zbatimit të projekteve, 0 pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore.***

Më hollësisht, analizuar sipas degëve të thesarit paraqitet kjo situatë e institucioneve shpenzuese buxhetore dhe ekstrabuxhetore sipas datave të depozitimit të pasqyrave financiare në MIE për vitin 2021:

Tabela nr.1

Nr	Emërtimi I institucionit buxhetor	Shkresa e subjektit mbi dërgimin ne MIE te PFIV	Nr prot dhe data e depozitimit te PFIV ne MIE
1.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë (Permbi)	Nr.4094/3, dt.14.4.2022	Nr.3236, dt 15.4.2022
	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë (Individuale)	Nr.4094/1, dt.29.3.2022	Nr.2999, dt 7.4.2022
2.	Instituti Transportit Tiranë	Nr.49/1, dt 24.3.2022	Nr.2601, dt.24.3.2022
3.	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës	Nr.265, dt 23.3.2022	Nr. 2665, dt 23.3.2022
4.	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës	Nr. 42, dt 10.2.2022	Nr.1865, dt 24.2.2022
5.	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit ne Aviacionin Civil Tiranë	Nr. 9, dt 12.4.2022	Nr.3171, dt 13.4.2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

6.	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve & Infrastrukturës së Mbetjeve Tiranë.	nr.756, dt.28.4.2022	Nr.3699, dt 6.5.2022
7.	Agjencia Kombëtare Bërthamore	Nr. 17/1 dt 13.4.2022	Nr.3173, dt 13.4.2022
8.	Agjencia e Evidencës së Energjisë	Nr.664, dt 30.3.2022	Nr. 2269, dt 31.3.2022
9.	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Nr.433/4, dt 28.3.2022	Nr.2738, dt 30.3.2022
10.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	Nr. 526/1, dt 12.4.2022	nr. 3151, dt 13.4.2022
11.	Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial	Nr.2948, dt 31.3.2022	Nr. 2273, dt 31.3.2022
12.	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan	Nr.62, dt 11.4.2022	Nr. 3100, dt 12.4.2022
13.	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	Nr.167, dt 24.2.2022	Nr.206, dt 2.3.2022
14.	Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve	Nr. 376, dt 29.3.2022	Nr. 2736, dt 30.3.2022
15.	Aparati MIE	Nr.2755, dt 30.3.2022	Nr.2755, dt 30.3.2022

Burimi: MIE, Përpunuar nga grupi i auditimit.

- **Numri total i institucioneve shpenzuese, që janë përfshirë në konsolidim nga ana e MIE, për vitin 2022, është 15 njësi/institucione publike, (duke përfshirë dhe aparatet e MIE), nga të cilat 15 institucione buxhetore, 0 ekstra-buxhetore, 0 njësi të zbatimit të projekteve, 0 pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore. Më hollësisht, subjektet e përfshira në konsolidim nga ana e MIE për këtë vit janë sipas listës më sipër.**

Analizuar sipas degëve të thesarit, paraqitet kjo situatë e institucioneve shpenzuese buxhetore dhe ekstrabuxhetore sipas datave të depozitimit të pasqyrave financiare në MIE për vitin 2022:

Tabela nr.2

Nr	Emërtimi i institucionit buxhetor	Shkresa e subjektit mbi dërgimin në MIE të PFIV	Nr prot dhe data e depozitimit të PFIV në MIE
1.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë (konsolid)	Nr.2841/2 ,dt 24.4.2023	Nr.ska, dt ska
2.	Instituti Transportit Tiranë	Nr.74 ,dt 29.3.2023	Nr.3297, dt 4.4.2023
3.	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës	Nr.453,dt 23.3.2023	Nr.3115, dt 29.3.2023
4.	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës	Nr. 48,dt 13.2.2023	Nr.2285, dt 27.2.2023
5.	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë	Nr. 24,dt 24.4.2023	Nr.4090, dt 5.5.2023
6.	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë.	Nuk janë dorëzuar	Nuk janë dorëzuar
7.	Agjencia Kombëtare Bërthamore	Nuk janë dorëzuar	Nuk janë dorëzuar
8.	Agjencia e Evidencës së Energjisë	Nr.ska ,dt ska	Nr.ska., dt.ska
9.	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Nr. 330,dt 20.3.2023	Nr.3337, dt 5.4.2023



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

10.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	Nr.360/1 ,dt 5.4.2023	Nr.3923, dt 28.4.2023
11.	Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial	Nr. 2528,dt 30.3.2023	Nr.3345, dt 6.4.2023
12.	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan	Nr.48 ,dt 12.4.2023	Nr.3542, dt 13.4.2023
13.	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	Nr.130 ,dt 21.2.2023	Nr.787/10, dt 21.2.2023
14.	Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve	Nr. 390,dt. 30.3.2023	Nr3221, dt 31.3.2023
15.	Aparati MIE	Nr. 3215,dt 31.3.2023	Nr. 3215,dt 31.3.2023

Burimi: MIE, Përpunuar nga grupi i auditimit.

Në bazë të të dhënave kontabile përkatëse janë përpiluar pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor (bilanci), që janë raportuar rregullisht si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare Individuale:

Nga ana e aparatit të institucionit, *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë* me shkresën Nr.2755, dt 30.3.2022 janë depozituar pasqyrat financiare individuale për vitin 2021, protokolluar në MFE; kurse me shkresën Nr. 3215,dt 31.3.2023, janë depozituar pasqyrat financiare për vitin 2022.

- Pasqyrat Financiare Përmbledhëse/ të Konsoliduara:

Tabela nr.3, Depozitimi në MFE i PFK te vitit 2021

Nr. Rendor	Ministritë e Linjes/	Kodi SIFQ	Statusi	Shkrese sipas Protokollit te Institucionit
1	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	1006001	Depozituar	nr. 3699/1, date 09.05.2022

Tabela nr. 3/1, Depozitimi në MFE i PFK te vitit 2022

Nr. Rendor	Ministritë e Linjes	Kodi SIFQ	Statusi	Shkrese sipas Protokollit te Institucionit
1	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1006001		Shkrese Nr 4489 date 22.05.2023

- Pasqyrat financiare të MIE **për vitin 2021** janë hartuar dhe depozituar sipas shkresës zyrtare nr. 3699/1, date 09.05.2022 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore janë shoqëruar nga relacioni shpjegues mbi pozicionin e posteve, zërave dhe llogarive përkatëse.
- Pasqyrat Financiare **të vitit 2022** janë hartuar dhe depozituar me shkresën zyrtare Shkrese Nr 4489, date 22.05.2023 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
Pasqyrat financiare të llogaridhënies e llogaridhënies vjetore, edhe për këtë vit janë shoqëruar me relacionin shpjegues mbi pozicionin e posteve, zërave dhe llogarive përkatëse.

- **Për vitin 2021, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore të MIE, ose afro 33 % e tyre, kanë dorëzuar me vonësë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, me tejkalim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë,**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.
përkatësisht, këto institucione për v.2021:

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit ne Aviacionin Civil Tiranë, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve & Infrastrukturës se Mbetjeve Tiranë, Agjencia Kombëtare Bërthamore Tiranë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Qendra e Grumbullimit, Trajtimin të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan.

✓ Për vitin 2022, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore MIE, ose afro 33,3 % e tyre, kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore, pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, me tejkalim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij. (përkatësisht, institucionet.....)
- Paragrafët nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018 dhe paragrafit nr.23, të UMF nr.5, datë 21.2.2022, pasi nuk është respektuar afati për depozitimim e PFK për vitin 2021 dhe 2022.

Përkatësisht, institucionet e mëposhtme për v.2022:

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit ne Aviacionin Civil Tiranë, Qendra e Grumbullimit, Trajtimin të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve Tiranë. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Agjencia Kombëtare Bërthamore.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se.

Pretendimi i subjektit: Institucionet që kanë dërguar me vonesë pasqyrat financiare në vitin 2021 dhe vitin 2022 duke qenë se janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit mars të vitit pasardhës pranë Degës së Thesarit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në Ministrinë apo Institucionin Qendror përkatës, vonesat mund të kenë ardhur edhe si pasojë e vonesave në Degën e Thesarit për shkak të ngarkesës së punonjësve të këtij institucioni për këtë procedurë në këtë afat kohor.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Observimi juaj është i njëjte me atë të paraqitur mbi aktetin e kontaktimit për të cilin janë paraqitur qëndrimet ne Projekt Raportin e dërguar zyrtarisht ne MIE. Si pasoje, observacioni nuk sjell asnjë prove dhe dëshmi të re, ndaj nuk merret në konsideratë pasi vonesat në hartimin apo depozitimim e PF individuale janë veprime e mosveprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, pavarësisht shkakut të vonesës.

Per sa sipër, gjetja do të vijojë të pasqyrohet ne Raportin Perfundimtar te auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

1. Titulli i gjetjes:	<i>Vonesa në dorëzimin e pasqyrave financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE për vitin 2021 dhe 2022.</i>
Situata:	<p>-Për vitin 2021, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore të MIE, ose afro 33 % e tyre, kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, me tejkalim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij. <i>Konkretisht:</i> Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime & Infrastrukturës së Mbetjeve Tiranë, Agjencia Kombëtare Bërthamore Tiranë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan.</p> <p>-Për vitin 2022, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore MIE, ose afro 33,3 % e tyre, kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore, pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, me tejkalim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë. <i>Konkretisht:</i> Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, Qendra e Grybullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Agjencia Kombëtare Bërthamore.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij; -Paragrafët nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018; -Paragrafi nr.23, të UMF nr.5, datë 21.2.2022.</p>
Ndikimi/Efekti:	Tejkalimi i këtij afati sjell vonesa në vijueshmërinë e procedurës së konsolidimit të llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore të MIE.
Shkaku:	Mos zbatimi i bazës ligjore nga disa institucione buxhetore për dorëzimin e pasqyrave individuale brenda afatit kohor.
Rëndësia:	E mesme-lartë.
1.1 Rekomandimi:	Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të zbatojnë me përpikmëri afatet kohore të përcaktuara në kuadrin rregullator përkatës.

- Nuk rezulton që Njësitë e Zbatimit të Projekteve për v.2021 dhe 2022 të kenë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë DBMF të MIE-së si dhe, nuk janë përfshirë PF e NJZP si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të njërive publike qendrore, në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 20, shkronja “c”, e UMF nr. 5, datë 21.2.2022, i cili ka parashikuar se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjeluar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:

.....

c. Konsolidimi i pasqyrave financiare në **nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara** të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, **njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve**), informacionin e Llogarisë qendrore të qeverisë, të Llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se.

Pretendimi i subjektit: Paragrafi 20, shkronja c), e udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë parashikon konsolidimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacion për borxhin qeveritar publik.

Në këtë kuptim është Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara duke përfshirë edhe ato të njësive të menaxhimit dhe zbatimit të projekteve.

Sqarojmë gjithashtu se nuk mund të konsolidohen pasqyra financiare shoqërite/ndermarrjet nenkontroll kjo sepse: - Institucionet buxhetore zbatojnë standartet kombëtare të kontabilitetit publik dhe -shoqëritë nën kontroll / ndërmarrjet zbatojnë standartet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe kanë një formë ligjore të ndryshme nga institucionet buxhetore. *Nuk mundet dy forma të ndryshme në përmabajtje dhe në rregulla të konsolidohen në një pasqyrë financiare. Kjo shkel çdo standard kombëtar e ndërkombëtar të raportimit financiar.*

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Paragrafi nr. 20 i UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 a përcaktuar se (cituar):

Në Kapitullin IV "Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara", paragrafi 101 ndryshon si më poshtë vijon:

Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (*duke bërë eliminimet dhe mënjeluar dublimet*) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:

a)Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel njësive publike qendrore, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (**aparati**), **të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike** qendrore;

Nga auditimi i kryer në MFE rezulton se nga ana e Njësive të Zbatimit të projekteve nuk janë depozitar atje pasqyrat e llogaridhënies vjetore, duke dëmtuar plotësinë dhe domosdoshmërinë e informacionit të tyre, si pjesë e kontabilitetit të sektorit publik. Grupi i auditimit e evidenton këtë parregullsi me qëllim marrjen e masave dhe bashkërendimin e veprimeve me MFE për të korrigjuar këtë parregullsi në vijim, në kushtet që dy projektet janë pjesë e MIE. Gjithashtu, grupi i auditimit nënvizon *faktin e mos përfshirjes në konsolidim të informacionin financiar të organit qendror të njësisë dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Ekonomisë.

Observimi juaj është i njejte me ate te paraqitur mbi aktetin e kontatimit per te cilin janë paraqitur qëndrimet ne Projekt Raportin e dërguar zyrtarisht ne MIE. Nën lidhje me rezervat mbi konsolidimin e PF të shoqrive dhe ndërmarrjeve, ku përfaqësuesit e MIE janë shprehur se : *Nuk mundet dy forma të ndryshme në përmabajtje dhe në rregulla të konsolidohen në një pasqyrë financiare. Kjo shkel çdo standard kombëtar e ndërkombëtar të rapoformit financiar*, këto objeksione duhet tia paraqisni Ministrise së Financave dhe Ekonomisë, e cila është politikëbërëse në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik.

Si pasojë, observacioni nuk sjell asnjë prove dhe dëshmi te re, ndaj nuk merret në konsideratë pasi vonesat në hartimin apo depozitimin e PF individuale janë veprime e mosveprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, pavarësisht shkakut të vonesës.

Per sa sipër, gjetja do te vijojte te pasqyrohet ne Raportin Perfundimtar te auditimit

2. Titulli i gjetjes:	<i>Njësitë e Zbatimit të Projekteve nuk kanë depozituar pasqyrat financiare vjetore pranë MIE dhe MFE, si rrjedhojë nuk janë përfshirë pasqyrat financiare të NJZP si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore. Audituesit e KLSH nënvizojnë faktin e mos përfshirjes në konsolidim të informacionin financiar të organit qendror të njësisë MIE, edhe të pasqyrave financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore MIE.</i>
Situata:	<p>Nuk rezulton që Njësitë e Zbatimit të Projekteve për vitin 2021 dhe 2022 të kenë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë DBMF të MIE-së si dhe, nuk janë përfshirë PF e NJZP si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore, në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 20, shkronjat “a” dhe “c”, e UMF nr. 5, datë 21.2.2022, i cili ka parashikuar se:</p> <p>Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (<i>duke bërë eliminimet dhe mënjeluar dublimet</i>) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:</p> <p>a) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel njësie publike qendrore, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore;</p> <p>....</p> <p>c. Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministër, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.</p>
Kriteri:	Paragrafi 20, shkronjat “ a” dhe “c” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.5, datë 21.02.2022.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e depozitimit të pasqyrave financiare të Njësisë të Zbatimit të Projekteve dhe mospërfshirja e tyre si pjesë e pasqyrave financiare të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

	konsoliduara të njërive publike qendrore sjell mungesë koherence në pasqyrat financiare të konsoliduara të MIE.
Shkaku:	Mos zbatimi i bazës ligjore nga Njësitë e Zbatimit të Projekteve në kuadër të depozitimit të pasqyrave financiare dhe përfshirja e tyre si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara.
Rëndësia:	E mesme-lartë.
2.1 Rekomandimi:	Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Njërive të Zbatimit të Projekteve të marrin masat dhe bashkërendojnë veprimet me MFE për të korrigjuar këtë parregullsi në vijim, dhe të zbatojnë me përpikmëri kuadrin rregullator përkatës mbi hartimin, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të NJZP dhe të pasqyrave financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore MIE, me qëllim përfshirjen e tyre në sistemin e raportimit financiar publik dhe pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel gupi.

Nuk janë përfshirë në setin e pasqyrave të konsoliduara, institucionet e mëposhtme:

- **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)**, kur në Nenin 3 “Përkufizime”, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndyshuar, nënvizohet se, “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)” është institucion me përgjegjësi planifikimi në *kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit*” si dhe mëtej në Nenin 8 “Përgjegjësitë e ministrisë së linjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të po këtij ligji.
- **Agjencia e Zhvillimit të Territorit -AZHT**, (e cila me pas ka kaluar në varësi të Kyeministrisë); si dhe
- **Njësitë e Zbatimit të Projekteve që mbulon kjo ministri**, (përkatësisht projektet e Drejtorisë së Fizibilitetit në fushën e Transporti dhe Infrastruktura dhe projektet e Drejtorisë së Fizibilitetit në fushën e Energjisë), në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.2.2022.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se.

Pretendimi i subjektit: Në zbatim të ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, MIE-s i janë miratuar fondet buxhetore dhe numri i punonjësve për 15 institucione varësie, përfshirë Aparatin e MIE.

AKPT nuk përfshihet në institucionet buxhetore varësi e MIE.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Audituesit e KLSH sjellin në vëmendje të MIE, se në objektin e veprimtarisë së k3tij institucioni është fusha e përgjegjësie mbi planifikimin dhe zhvillimin urban.

• Në lidhje me AKPT:

Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, “Neni 3, “Përkufizime”, ka shprehur se:

“Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)” është institucion me përgjegjësi planifikimi *në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit*”;

VKM Nr. 427, datë 8.6.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Planifikimit të Territorit” ka përcaktuar në pikën nr.1 dhe 2 të tij se:

1. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në vijim “AKPT”, organizohet dhe funksionon në përputhje me këtë vendim dhe me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar. 2. AKPT-ja është person juridik publik, buxhetor, me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit urban, me seli në Tiranë.

Observimi i paraqitur nga MIE është i njëjtë me atë të paraqitur mbi aktin e konstatimit për të cilin janë paraqitur qëndrimet në Projekt Raportin e dërguar zyrtarisht në MIE. Si pasojë, observacioni nuk sjell asnjë provë dhe dëshmi të re, ndaj nuk merret në konsideratë pasi këto veprime e mosveprime bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, mbi mënyrën e hartimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore.

Per sa sipër, gjetja do të vijojë të pasqyrohet në Raportin Perfundimtar të auditimit Per sa sipër, gjetja do të vijojë të pasqyrohet në Raportin Perfundimtar të Auditimit

3. Titulli i gjetjes:	<i>Mospërfshirja në setin e pasqyrave të konsoliduara e të gjitha institucioneve që shtihen brneda fushës së përgjegjesisë së Ministrisë, të kërkuara sipas kuadrit ligjor.</i>
Situata:	Nuk janë përfshirë në setin e pasqyrave të konsoliduara, institucionet e mëposhtme: -Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT), kur në Nenin 3 “Përkufizime”, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nënvizohet se, “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)” është institucion me përgjegjësi planifikimi në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit” si dhe mëtej në Nenin 8 “Përgjegjësitë e ministrisë së linjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të po këtij ligji. -Agjencia e Zhvillimit të Territorit -AZHT, (e cila me pas ka kaluar në varësi të Kyeministrisë); si dhe -Njësitë e Zbatimit të Projekteve që mbulon kjo ministri, (përkatësisht projektet e Drejtorisë së Fizibilitetit në fushën e Transporti dhe Infrastruktura dhe projektet e Drejtorisë së Fizibilitetit në fushën e Energjisë), në kundërshtim me UMF nr.5, datë 21.2.2022.
Kriteri:	-Neni 3 dhe neni 8 i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; -UMF nr. 5 datë 21.02.2022.
Ndikimi/Efekti:	Mospërfshirja e të gjithë institucioneve dhe njërive të zbatimit të projekteve si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara nuk paraqet një pamje të plotë të performancës financiare të grupit/ ministrisë dhe institucioneve të varësisë.
Shkaku:	Mos zbatimi i bazës ligjore nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë në kuadër të depozitimit të pasqyrave financiare të konsoliduara.
Rëndësia:	E mesme.
3.1 Rekomandimi:	Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë të zbatojnë me përpikmëri kuadrin rregullator përkatës dhe të saktësojnë numrin e institucioneve që duhet të përfshihen në konsolidimin financiar e kontabël.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

- Për shkeljet ligjore, në lidhje me mos respektimin e afatit të depozitimit të Pasqyrave Financiare Individuale nga ana e njësisve shpenzuese/ institucioneve shtetërore buxhetore apo ekstra-buxhetore etj., nuk është kërkuar marrja e masave administrative nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues. Më hollësisht, evidentohet se,

Për vitin 2021:

- Dorëzimi i PFK nga ana e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, është bërë me datën 12.4.2022, ose **12 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve & Infrastrukturës së Mbetjeve Tiranë, është bërë me datën 28.4.2022;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Agjencia kombëtare Bërthamore Tiranë, është bërë me datën 13.4.2022, ose **13 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e subjektit Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është bërë me datën 12.4.2022, ose **12 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan, është bërë me datën 11.4.2022, ose **11 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre.

Për vitin 2022:

- Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë”, nuk janë dorëzuar PFK e viti 2022;
- Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare Bërthamore Tiranë”, nuk janë dorëzuar PFK e viti 2022;
- Dorëzimi i PFK nga ana e subjektit Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë 24.4.2023 dhe protokolluar në MIE me datën 5.5.2023, ose **35 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Qendrës së Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan është bërë me datën 12.4.2023, ose **12 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është bërë me datën 5.5.2023, ose **35 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e:

- Nenit 71, germa ”e“, Kreu IX, të ligjit Nr. 9936, datë “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, që thekson (citojmë):
 - e) kur nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme nuk përmbushin detyrimet për mbylljen e vitit buxhetor dhe nxjerrjen e llogarive vjetore të buxhetit, në kundërshtim me nenin 62 të këtij ligji, dënohen nga nëpunësi i parë autorizues me masë administrative ose me gjobë në masën 1-3 paga mujore.
- Paragrafit nr. 45, Kreu V, të Udhëzimit nr.25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, ku është shprehur se, (cituar):
“Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësit autorizues dhe zbatues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Paragrafit nr. 45, Kreu VI “Masat administrative”, të Udhëzimit nr.34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022, (cituar):



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

“Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” , i ndryshuar.

II. Auditimi dhe analiza e informacionit kontabël dhe i të dhënave të Pasqyrave Financiare Individuale Vjetore të depozituara nga institucionet shpenzuese të varësisë pranë MIE:

Procesi i auditimit të institucioneve buxhetore, si dhe ai i analizimit të pasqyrave financiare individuale vjetore (PFIV) ka nxjerrë në pah:

- Dobësi dhe mangësi në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga subjektet e varësisë, ka vonesa e cilësi të dobët të informacionit financiar, llogari kontabile që nuk kanë analiza inventariale dhe të rezultojnë të pafunditë, ku këtu kanë ndikuar edhe fakti i ristrukturimeve të ministrive dhe institucioneve qendrore e vendore;
- Një sërë mospërputhesh ndërmjet pasqyrave individuale dhe konsolidimit të tyre në Pasqyrat financiare të nivelit të gupit nga ana e institucionet e qeverisjes së përgjishme;
- Parregullsi në zbatimin e kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21.02.2022 mbi përgatitjen dhe hartimin e këtyre pasqyrave. Kjo për shkak se disa prej Njësive Shpenzuese Buxhetore (NJSB), nuk kanë regjistruar dhe pasqyruar drejt disa zëra të llogarive në pasqyrat e tyre financiare dhe Ministrinë e linjës administrative kanë bërë konsolidimin e këtyre të dhënave ashtu siç janë raportuar nga institucionet publike dhe subjektet buxhetore raportuese, si dhe
- Mospërputhje ndërmjet të dhënave të pasqyrave të llogaridhënies vjetore individuale me ato të regjistruara në Sistemin Informativ Financiar të Qeverisë (SIFQ), duke dhënë ndikimin e tyre në rezultatet dhe shtësinë e informacionit kontabël të konsoliduar, për hartimin e Pasqyrave Financiare të Qeverisjes së Përgjithshme.

Midis pasqyrave fizike të dorëzuara nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), rezultojnë diferenca, për shkak se:

- ✓ Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ, pasqyrohen shpenzimet faktike të vitit, ndërsa në pasqyrat fizike (manuale) të institucioneve buxhetore pasqyrohen detyrimet e konstatuara dhe të papaguara, *si pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo detyrimi për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit dhe paguhen me buxhetin e vitit të ardhshëm;*
- ✓ Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ pasqyrohen arkëtimet e vitit, ndërsa në pasqyrat fizike të institucioneve buxhetore, pasqyrohen të drejtat e konstatuara dhe të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme, siç janë debitorët.

Nga ana e KLSH-së, prej disa vitesh është kërkuar që, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masa për hartimin e një metodologjie për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare të qeverisë në përputhje me rregullat bazë të kontabilitetit, por nuk rezulton të ketë një realizim të kësaj detyrimi me finalizimin e këtyre pasqyrave në nivelin e sektorit publik.

Parregullsitë, mangësitë apo mospërputhjet në shifrat e konsoliduara dhe pasqyrat financiare, kanë të bëjnë me çështjet si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09.2023 shpreh se:

Pretendimi i subjektit: Meqenëse në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ, pasqyrohen shpenzimet faktike të vitit dhe arkëtimet e vitit, ndërsa në pasqyrat fizike të institucioneve buxhetore pasqyrohen detyrimet e konstatuara dhe të papaguara me të drejta të konstatuara dhe të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme siç janë debitorët, **ashtu siç është konstatuar edhe nga KLSH, duhet që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të hartojë një metodologji për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare në përputhje me parimet e kontabilitetit në sektorin publik** ku edhe profesioni i kontabilistit publik të jetë një profesion i licensuar nga MFE, sikurse audituesit e brendshëm në sektorin publik.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Objeksioni i MIE nuk sjell ndonjë argument kundërshtues për konstatimin.

Observimi i paraqitur nga MIE është i njëjtë me atë të paraqitur mbi aktin e konstatimit për të cilin janë paraqitur qëndrimet në Projekt Raportin e dërguar zyrtarisht në MIE. Si pasoje, observacioni nuk sjell asnjë provë dhe dëshmi të re, ndaj nuk merret në konsideratë pasi këto veprime e mosveprime bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, mbi mënyrën e hartimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore.

Per sa sipër, gjetja do të vijojë të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të auditimit

4. Titulli i gjetjes:	<i>Mungesa e marrjes së masave administrative nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues si dhe nga ana e drejtuesve të MIE për NA dhe NZ e varësisë direkte, për mos respektimin e afatit të depozitimit të Pasqyrave financiare Individuale.</i>
Situata:	<p>Për shkeljet ligjore, në lidhje me mos respektimin e afatit të depozitimit të Pasqyrave Financiare Individuale nga ana e njësisve shpenzuese/ institucioneve shtetërore buxhetore apo ekstrabuxhetore etj., nuk është kërkuar marja e masave administrative nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues. Më hollësisht, evidentohet se:</p> <p><u>Për vitin 2021:</u></p> <ul style="list-style-type: none">-Dorëzimi i PFK nga ana e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurine e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, është bërë me datën 12.4.2022, ose 12 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;-Dorëzimi i PFK nga ana e Agjencisë kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve & Infrastrukturës së Mbetjeve Tiranë, është bërë me datën 28.4.2022;-Dorëzimi i PFK nga ana e Agjencia kombëtare Bërthamore Tiranë, është bërë me datën 13.4.2022, ose 13 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;-Dorëzimi i PFK nga ana e subjektit Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është bërë me datën 12.4.2022, ose 12 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;-Dorëzimi i PFK nga ana e Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan, është bërë me datën 11.4.2022, ose 11 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre; <p><u>Për vitin 2022:</u></p> <ul style="list-style-type: none">-Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

	<p>Tiranë”, nuk janë dorëzuar PFK e viti 2022; -Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare Bërthamore Tiranë”, nuk janë dorëzuar PFK e viti 2022; -Dorëzimi i PFK nga ana e subjektit Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë 24.4.2023 dhe protokolluar në MIE me datën 5.5.2023, ose 35 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre; -Dorëzimi i PFK nga ana e Qendrës së Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan është bërë me datën 12.4.2023, ose 12 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre; -Dorëzimi i PFK nga ana e Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është bërë me datën 5.5.2023, ose 35 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre.</p>
Kriteri:	<p>-Neni 71, gërma “e”, kreu IX, ligji Nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar; -paragrafi 45, kreu V i Udhëzimit nr. 25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”; -paragrafi 45, kreu VI i Udhëzimit nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e marrjes së masave administrative mund të jetë shkak për përsëritje të mos respektimit të afatit depozitimit të pasqyrave financiare individuale.
Shkaku:	Mungesa e marrjes së masave administrative për mos respektimin e afatit të depozitimit të pasqyrave financiare individuale.
Rëndësia:	E mesme.
4.1 Rekomandimi:	<p>1.1. Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të merren masat për të administruar sipas afateve ligjore të miratuara, pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, individuale në afat nga të gjithë institucionet e sektorit publik.</p> <p>1.2. Nga ana e MIE të drejtohet dhe monitorohet procesi i konsolidimit dhe rakordimit të informacionet kontabël dhe gjendjet/ tepricat e llogarive si dhe realizimit të procesit të eliminimit të dublikimeve, përmbledhjes dhe konsolidimit në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, për institucionet e sektorit publik në varësi.</p> <p>1.3. Për të gjitha rastet e mosrespektimit të këtyre afateve nga ana e institucioneve përgjegjëse, të kërkohet nga Nëpunësi i Parë Autorizues sanksionet e parashikuara ligjore, si kundrejtë titullarëve të institucioneve shtetërore, ashtu edhe ndaj nëpunësve autorizues dhe zbatues përkatës, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor.</p>

- Nga kryqëzimet e informacionit dhe auditimi i treguesve të pasqyrave financiare të gjeneruar nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) rezulton se për vitin 2021 dhe 2022, **pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore** në 9 institucione të varësisë administrative nga MIE, **për llogarinë nr. 210, “Toka, troje dhe terrene”, e kanë të pasqyruar vlerën zero lekë, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive**, në mospërputhje me përcaktimet e paragrafit 60 dhe 62, pika 3.3, “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci) kreu III, të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se:

60. Pasqyra individuale e pozicionit financiar (bilanci kontabël) pasqyron në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet, detyrimet dhe fondet neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues. Si rregull, periodha ushtrimore është nga data 1 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit raportues.

62. Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme të tjera aktive afatshkurtra.

-Nënrubrika e “mjetete monetare dhe ekuivalentët e tyre” analizon mjetet monetare (në arkë dhe bankë) si dhe ekuivalentët e tyre (si letra me vlerë, disponibilitete në thesar, etj);

-Nënrubrika “gjendje inventari qarkullues” analizon të gjithë elementët e inventarit të stokuar (si inventar i imët, prodhim në proces, produkte, etj);

-Nënrubrika “llogari të arkëtueshme” evidenton llogaritë e të drejtave që ka njësia për të arkëtuar në fund të periudhës raportuese (si klientë, tatime dhe taksa, debitorë të ndryshëm, etj);

-Nënrubrika “të tjera aktive afatshkurtra” analizon elementë si parapagime, shpenzime për t’u shpërndarë në disa ushtrime, etj.

Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë:

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj;

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata financiare, që përfshin huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet; dhe

-Nënrubrika e investimeve, që përfshin aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.

Të dhënat në lekë

Nr	Emërtimi I institucionit buxhetor	31.12.2022	31.12.2021
1.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë	x	x
2.	Instituti Transportit Tiranë	0	0
3.	Drejtorja e Përgjithshme Detare Durrës	0	0
4.	Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor Durrës	0	0
5.	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurine e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë	0	0
6.	Agjencia kombëtare e Ujesjelles Kanalizimeve Tiranë.	0	0
7.	Agjencia kombëtare Berthamore	0	0
8.	Agjencia e Efiçences së Energjisë	x	x
9.	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	x	x



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

10.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	x	x
11.	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial	0	0
12.	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan	x	x
13.	Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	0	0
14.	Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve	0	0
15.	Aparati MIE	x	x

Burimi: MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe menaxhimit Financiar, përpunuar nga grupi i auditimit.

5. Titulli i gjetjes:	<i>Nuk është regjistruar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare për periudhën 2021- 2022 vlera e trojeve në administrim të institucionit. ndikojnë në funksionimin e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrimit me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël në shumë institucione publike.</i>
Situata:	<p>Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2021, llogaria nr. 210 “Toka, troje e terrene” është në vlerën zero lekë dhe nuk janë regjistruar këto sipërfaqe toke në kontabilitetin e njërive shpenzuese buxhetore, ndonëse sipas VKM përkatëse, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objekteve ndërtimore dhe truallit, për llogari të këtyre institucioneve. Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet duke filluar nga çmimi 66,969 lekë/m² për këto zona kadastrale.</p> <p><i>Kjo parregullsi është evidentuar për institucionin e Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial, Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës, Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, Instituti Transportit Tiranë, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit ne Aviacionin Civil Tiranë, etj.</i></p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</p> <p>-VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>-UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.</p> <p>-Pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

	<p>përgjithshme”, që përcakton se:</p> <p>“62. Aktivete paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata.....</p> <p>Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"><input type="checkbox"/> Nënrubrika e aktiveve afatgjata jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;<input type="checkbox"/> Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj;<input type="checkbox"/> Nënrubrika e aktiveve afatgjata financiare, që përfshin huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet; dhe<input type="checkbox"/> Nënrubrika e investimeve, që përfshin aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale. <p>91. Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me kosto historike), sipas rreshtave, përfaqëson:</p> <ul style="list-style-type: none"><input type="checkbox"/> Rubrika I “aktive afatgjata jomateriale”, e cila përfshin prime të emisionit dhe rimbursimit të huarve, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të ngjashme.<input type="checkbox"/> Rubrika II “aktive afatgjata materiale”, e cila përfshin zëra si: toka, troje, pyje, ndërtime e konstruksione, mjete transporti, rezerva shtetërore, kafshë pune e prodhimi, inventar ekonomik, etj.<input type="checkbox"/> Totali i aktiveve afatgjata, për çdo zë të evidentuar në kolonat e pasqyrës, paraqitet në rreshtin e fundit të kësaj pasqyre.
Ndikimi/Efekti:	Nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të mbyllura për periudhën 2021 dhe 2022 vlera kontabile e llogarisë ekonomike 210 “Toka, troje e terrene”, tek grupi i Aktiveve Afatgjata Materiale për disainstitucione shtetërore, duke denaturuar informacionin financiar e kontabël.
Shkaku:	Është ndikuar nga faktorë të jashtëm, si mos pasqyrimi në kontabilitet i vlerës kontabile të tokës mbi të cilën ngrihet ndërtesa si dhe oborrit në dispozicion nga ana e institucionit.
Rëndësia:	E mesme.
5.1 Rekomandimi:	Të merren masat nga NA dhe NZ i MIE, që të kërkojnë nga Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të njëjve shpenzuese, buxhetore e ekstra-buzhetore dhe Degët e Thesarit sipas juridiksionit dhe të marrin masa për vlerësimin, regjistrimin dhe evidentimin e saktë të gjendjes së llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në kontabilitet, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truell nën objektet e ndërtesave të pasqyruara në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, si dhe vlera e trojeve dhe terreneve, të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave u janë kaluar në pronësi të institucioneve shtetërore etj.

Konstatim nr.6:

Teprica debitore e Llog.486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme”, sipas PFK të MIE për vitin 2021 janë evidentuar (për ushtrimin e mbyllur me dt.31.12.2021), në vlerën **1,966,810,355 lekë** vlerë, e cila është mbartur me korrektesë në çelje të në PFK të vitit 2022, dhe për vitin 2022 për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

542,573,164 lekë. Pra, nuk rezulton të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 468.

Sa më sipër, analiza e pasqyrave financiare të gjeneruar nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) tregon se për vitin 2020, 2021 dhe 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në shumicën e institucioneve buxhetore të vartësisë, nuk kanë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III” Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me **llogarinë nr. 4864, “Shpenzime të periudhave të ardhshme”,** (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, kreu III” Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”), ku përcaktohet shprehimisht se:

Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 42 ndryshon si vijon:

Degët e Thesarit regjistruar në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njësitë të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin Llogarinë kontabël 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njësitë të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në Llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së Llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të Llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31 Dhjetor 2021.

Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara.

Tabela Institucionet që nuk kanë kryer veprimet kontabile të mbylljes së llogarisë 486 dhe rezultojnë me gjendje në PF individuale vjetore:

Të dhënat në lekë

Nr	Emërtimi I institucionit buxhetor	31.12.2021
1.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë	133,711,658
2.	Instituti Transportit Tiranë	0
3.	Drejtorja e Përgjithshme Detare Durrës	0
4.	Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor Durrës	
5.	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë	0
6.	Agjencia Kombëtare e Ujesjelles Kanalizimeve Tiranë	494,647,742
7.	Agjencia Kombëtare Berthamore	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

8.	Agjencia e Efijences se Energjise	33,258,089
9.	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	0
10.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minier	60,000
11.	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial	0
12.	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan	0
13.	Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	0
14.	Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve	0
15.	Aparati MIE	
	Shuma	1,966,810,355

Burimi: MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe menaxhimit Financiar, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi evidentohet se DBMF në Llogaridhënien Vjetore të institucionit ka përfshirë dhe plotësuar pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, atë të flukseve monetare (*cash flow*), investimet sipas burimeve të financimit, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet afatgjata, pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave së bashku me pyetësin dhe shënimet shpjeguese.

Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës të kontabilitetit dhe më tej të dhënat janë pasqyruar në bilancin vjetor të veprimtarisë. Nga ana e Drejtorisë përgjegjëse janë mbajtur Ditari i bankës, ditari i magazinës (si për aktivet afatgjata, ashtu dhe ditari për aktivet e magazinës); Regjistri i Shpenzimeve të vitit, Fletët e kontabilizimit, etj.

Nga ana e audituesve të KLSH u kryen verifikime mbi bazë testimesh substanciale, në lidhje me llogaritë inventariale të aktiveve qarkulluese, aktiveve afatgjata materiale, etj.

Konstatohet se, për periudhën e audituar, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat vjetore të MIE, janë mbajtur akt rakordimet vjetore dhe janë kundër-firmuar rregullisht të dënata nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. *Për sa sipër*, është vepruar në përputhje me përcaktimet e:

- ligjit nr.9936, date 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 3, pikat 4 dhe 5, qe sanksionon se këtij ligji i nënshtrohen te gjithë NJQP,
- 4. “Qeverisje e përgjithshme” është tërësia e njërive të qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale. 5. “Njësi të qeverisjes qendrore” janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore.
- paragrafit nr.221, të Kreut IV, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, që përcakton se:
Nëpunësi zbatues rakordon çdo muaj me strukturën përgjegjëse të thesarit në degë për të ardhurat progresive që ka realizuar njësia shpenzuese e qeverisjes së përgjithshme.
- paragrafit nr.12, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se:
Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 37 ndryshohet me këtë përmbajtje: Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

detyruara të rakordojnë me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave, shpenzimeve dhe pagesave, për vitin që raportohet (sipas formatit të gjeneruar nga SIFQ). Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09.2023 shpreh se:

Pretendimi i subjektit: Ka pasaktësi në konstatimet tuaja të vlerave për tepricat e llogarisë 486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme” pasi vlera 1.305.132.866 lekë është për pasqyrat individuale të Aparatit MIE për vitin 2021, ndërsa vlera 1.966.909.147 lekë është sipas PFK për vitin 2021 dhe vlera 542.573.164 lekë është sipas PFK për vitin 2022. Per kete pike, observacioni eshte reflektuar ne raport.

Aparati i MIE ka kryer veprimin e mbylljes me llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën prej 1.305.132.866 lekë në vitin 2022. Gjithashtu, për sa jeni shprehur po në këtë konstatim, se nuk janë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III për procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me llogarinë 4864, të Shpenzimeve të periudhave të ardhshme, Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për detyrimet e prapambetura në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31 Dhjetor 2021. **Pasqyrat financiare të vitit 2020, 2021 janë hartuar në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018** “ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu III, paragrafi 42 ku citohet “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observacioni është pranuar për saktësimin e të dhënave, por është i pa bazuar ligjërish dhe teknikisht e metodikisht, në lidhje me sistemit e llogarisë 486 nuk janë kryer nga njësitë shpenzuese, pjesë e përmbledhjes nga MIE. Ka një pasaktësi në observacionin e NZ të MIE, që shpreh se “Pasqyrat financiare të vitit 2021 janë hartuar në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018”..., pasi paragrafi nr.28, i Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, ka përcaktuar se” Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2021”, që do të thotë se këto rregullime kontabile duhet të ishin kryer patjetër për pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021 dhe 31.12.2022.

Observimi nga MIE është i njëjtë me atë të paraqitur mbi aktin e konstatimit për të cilin janë paraqitur qëndrimet në Projekt Raportin e dërguar zyrtarisht në MIE. Si pasoje, observacioni nuk sjell asnjë provë dhe dëshmi të re, ndaj nuk merret në konsideratë pasi këto veprime e mosveprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, mbi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

mënyrën e hartimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore.

Per sa sipër, gjetja do te vijojte te pasqyrohet ne Raportin Përfundimtar te auditimit

6. Titulli i gjetjes:	<i>Në pasqyrat financiare të konsoliduara të MIE për vitin 2021, teprica debitore e llogarisë 486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme” janë 1,966,810,355 lekë dhe në pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2022, 542,573,164 lekë. Pra, nuk rezulton të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 468.</i>																																				
Situata:	<p>Teprica debitore e Llog.486 “Shpenzimet e periudhave te ardhshme”, sipas PFK të MIE për vitin 2021 janë evidentuar (për ushtrimin e mbyllur me dt.31.12.2021), në vlerën 1,966,810,355 lekë vlerë, e cila është mbartur me korrektesë në çeleje të në PFK të vitit 2022, dhe për vitin 2022 për 542,573,164 lekë. <u>Pra, nuk rezulton të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 468.</u></p> <p>Sa më sipërr, analiza e pasqyrave financiare të gjeneruar nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) tregon se për vitin 2020, 2021 dhe 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në shumcën e institucioneve buxhetore të vartësisë, nuk kanë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III” Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me <u>llogarinë nr. 4864, “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, kreu III” Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”)</u>.</p> <p><i>Më konkretisht,</i></p> <p>Tabela nr. Institucionet që nuk kanë kryer veprimet kontabile te mbylljes së llogarisë 486 dhe rezultojnë me gjendje në PF individuale vjetore:</p> <p style="text-align: right;"><i>Të dhënat në lekë</i></p> <table border="1" data-bbox="427 1391 1445 2024"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Emërtimi I institucionit buxhetor</th> <th>31.12.2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1.</td> <td>Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë</td> <td>133,711,658</td> </tr> <tr> <td>2.</td> <td>Instituti Transportit Tiranë</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>3.</td> <td>Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>4.</td> <td>Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës</td> <td></td> </tr> <tr> <td>5.</td> <td>Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurine e Operimit ne Aviacionin Civil Tiranë</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>6.</td> <td>Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizimeve Tiranë.</td> <td>494,647,742</td> </tr> <tr> <td>7.</td> <td>Agjencia Kombetare Berthamore</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>8.</td> <td>Agjencia e Efijences se Energjise</td> <td>33,258,089</td> </tr> <tr> <td>9.</td> <td>Sherbimi Gjeologjik Shqiptar</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>10.</td> <td>Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minier</td> <td>60,000</td> </tr> <tr> <td>11.</td> <td>Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	Emërtimi I institucionit buxhetor	31.12.2021	1.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë	133,711,658	2.	Instituti Transportit Tiranë	0	3.	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës	0	4.	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës		5.	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurine e Operimit ne Aviacionin Civil Tiranë	0	6.	Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizimeve Tiranë.	494,647,742	7.	Agjencia Kombetare Berthamore	0	8.	Agjencia e Efijences se Energjise	33,258,089	9.	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	0	10.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minier	60,000	11.	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial	0
Nr	Emërtimi I institucionit buxhetor	31.12.2021																																			
1.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë	133,711,658																																			
2.	Instituti Transportit Tiranë	0																																			
3.	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës	0																																			
4.	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës																																				
5.	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurine e Operimit ne Aviacionin Civil Tiranë	0																																			
6.	Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizimeve Tiranë.	494,647,742																																			
7.	Agjencia Kombetare Berthamore	0																																			
8.	Agjencia e Efijences se Energjise	33,258,089																																			
9.	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	0																																			
10.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minier	60,000																																			
11.	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial	0																																			



KONTROLLI I LARTË I SHITIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

	12.	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan	0
	13.	Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit	0
	14.	Agjensia Shtetërore e Shpronësimeve	0
	15.	Aparati MIE	
		Shuma	1,966,810,355
	Burimi: MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe menaxhimit Financiar, përpunuar nga grupi i auditimit.		
Kriteri:	- paragrafi 15, pika 3.1, kreu III” Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.		
Ndikimi/Efekti:	Parregullsi në zbatimin e teknikave të kontabilitetit dhe uniformizimin e informacionit financiar për efekt konsolidimi në nivel grupi.		
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave të UMFE nr.5, datë 21.2.2022.		
Rëndësia:	E mesme-lartë.		
4.1 Rekomandimi:	Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë të marrë masa për të monitoruar zbatimin e normave teknike dhe ndjekë procesin e sistemeve në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në kundërt parti në e saj, llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për pasqyrat financiare të ushtrimit që mbyllet më 31.12.2023, meqenëse llogaria 486 si llogari e pozicionit financiar luan rolin e një llogarie teknike për identifikimin e detyrimeve të prapambetura.		

- Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejtë listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të miratuar nga VKM dhe kaluar në përgjegjësi administrimi të ministrisë dhe subjekteve të varësisë direkte.

Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021 dhe më 31.12.2022, Aktivitet Afatgjatë Materiale pasqyrojnë edhe vlera të investimeve për rikonstruksioneve të kryera në objekte që nuk i përkasin MIE dhe kanë patur në përdorim të përkohshëm, përgjithësisht kjo e lidhur me objekte ndërtimore të ish-ministrive që i janë bashkuar MIE, si dhe AAJM të cilat nuk janë transferuar dhe jepen në vijim:

Kështu mund të përmendim p.sh:

- Rikonstruksioni i kryer për **Zyrat e Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimi**, në dhe që rezultojnë në PF të Aparatit të MIE.
- **Vlera e planeve të përgjithshme vendore, pjesë e llog.202 “Studime dhe kërkime”, prej 1,345,048,518 lekë, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore. Planet e Përgjithshme Vendore i përkasin objekteve të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabl të Aparatit të MIE, dhe që u përkasin bashkive respektive. Nga ana e MIE gjatë vitit 2021 nuk rezultojnë të jenë ndërrmarrë veprimet për transferimin dhe sistemin e tyre kontabël sipas ligjit.**

Nga ana formale, Llogaria e vitit 2021 dhe 2022 është paraqitur e protokolluar në Ministrinë e Linjës Administrative (MIE), sipas numrit e datave të paraqitjes që tregohen në informacionin i cili jepet më sipër. Jo në të gjitha rastet llogaria është shoqëruar me pyetësorin e plotësuar sipas kërkesave të UMFE nr. 8, datë 9.3.2018; mos plotësimi i të gjitha pasqyrave financiare anekse, mos shoqërimi i llogaridhënies me relacionin shpjegues apo relacioni është sipërfaqësor dhe jo i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

plotë, etj. Në vijim janë evidentuar disa problematika për përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar për llogaridhënien vjetore në vazhdimësi.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se:

Pretendimi i subjektit: Për sa shpreheni se ka pasaktësi në evidentimin në kontabilitet te vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe se në Pasqyrat Financiare të mbyllura me 31.12.2021 dhe më 31.12.2022, Aktivet Afatgjata Materiale pasqyrojnë edhe vlera të investimeve Për rikonstruksioneve të kryera në objekte që nuk i përkasin MIE dhe kanë patur në përdorim të përkohshëm, përgjithësisht kjo e lidhur me objekte ndërtimore të ish-ministrive që janë bashkuar MIE, si dhe AAJM të cilat nuk janë transferuar dhe jepen në vijim, ju sqarojmë: *Ka një keq interpretim për Rikonstruksionin e kryer Për Zyrat e Komisionarit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit*, dhe që rezultojnë në PF të Aparatit të MIE, dhe ju saktësojmë se Rikonstruksioni është kryer në godinën e ish- Ministrisë së Zhvillimit Urban (sot MIE), Për zyrat i ka pasur në përdorim të përkohshëm Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit në këtë ndërtesë, dhe pasqyrimi në pasqyrat financiare të Aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është i saktë.

Për sa jeni shprehur, po në këtë konstatim për vlerën e planeve vendore, pjesë e llog.202 "Studime dhe kërkime", te cilat i përkasin objekteve të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabël të Aparatit të MIE, shprehemi se do të angazhohemi për të ndërmarre veprimet Për transferimin dhe sistemimin e tyre kontabël bashkive respektive.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1.Observacioni në lidhje me rikonstruksionin e kryer për Zyrat e Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit, dhe që rezultojnë të jene evidentuar në analizat e llogarive dhe në PF të Aparatit të MIE, nga kjo e fundit nuk është sjellë asnjë dokumentacion justifikues mbi kontratën e punimeve, edhe emërtesa në analizat e llogarive është cituar "Rikonstruksionin e kryer Për Zyrat e Komisionarit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit". Gjithashtu, nga intervistat e zhvilluara nga ana e audituesve të KLSH me zyrtarë të stafit të MIE, është marrë konfirmimi se investimet janë kryer në godinën e administruar nga Komisionarit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit.

2. Lidhur me vlerën e planeve vendore, pjesë e llog.202 "Studime dhe kërkime", te cilat i përkasin objekteve të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabël të Aparatit të MIE, nga MIE nuk është ndërmarrë prej disa vitesh asnjë veprim sistemi, pavarësisht angazhimit për të ndërmarre veprimet për transferimin dhe sistemimin e tyre kontabël bashkive respektive.

Sa më sipër, observacioni është i pa bazuar ligjërisht dhe duhet të ish kryer patjetër për pasqyrat finnciare të mbyllura më 31.12.2021 dhe 31.12.2022.

Observimi i paraqitur nga MIE është i njëjtë me atë të paraqitur mbi aktin e konstatimit për te cilin janë paraqitur qëndrimet në Projekt Raportin e dërguar zyrtarisht në MIE. Si pasoje, observacioni nuk sjell asnjë prove dhe dëshmi të re, ndaj nuk merret në konsideratë pasi këto veprime e mosveprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, mbi mënyrën e hartimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore.

Per sa sipër, gjetja do të vijojë të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të auditimit

7.Titulli gjetjes:	<i>Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të miratuar nga VKM dhe kaluar në përgjegjësi administrimi të</i>
---------------------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

	<i>ministrisë dhe subjekteve të varësisë direkte.</i>
Situata:	<p>Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021 dhe më 31.12.2022, Aktivitet Afatgjatë Materiale pasqyrojnë edhe vlera të investimeve për rikonstruksioneve të kryera në objekte që nuk i përkasin MIE dhe kanë patur në përdorim të përkohshëm, përgjithësisht kjo e lidhur me objekte ndërtimore të ish-ministrive që i janë bashkuar MIE, si dhe AAJM të cilat nuk janë transferuar dhe jepen në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">• Rikonstruksioni i kryer për <i>Zyrat e Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimi</i>, në dhe që rezultojnë në PF të Aparatit të MIE;• <i>Vlera e planeve të përgjithshme vendore, pjesë e llog.202 “Studime dhe kërkime”, prej 1,345,048,518 lekë, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore. Planet e Përgjithshme Vendore i përkasin objekteve të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabël të Aparatit të MIE, dhe që u përkasin bashkive respektive. Nga ana e MIE gjatë vitit 2021 nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë veprimet për transferimin dhe sistemin e tyre kontabël sipas ligjit.</i>
Kriteri:	<p>-Ligji nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar; -Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme”; -Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, etj.</p>
Ndikimi/Efekti:	Parregullsi në zbatimin e teknikave të kontabilitetit dhe informacionit financiar nga ana e Aparatit të MIE.
Shkaku:	Mos veprimet e strukturave përgjegjëse në MIE.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<ol style="list-style-type: none">1. MIE, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për saktësimin e analizës së llogaritve dhe të bëjnë korrigjimet dhe sistemin e domosdoshme, duke bërë që në këtë llogari të aktiveve afatgjatë materiale të paraqitet vlera e drejtë dhe e raketuar sipas kërkesave të teknikave kontabël.2. Nga ana e MIE gjatë vitit 2021 të merren masat për transferimin e vlerës së planeve të përgjithshme vendore, kontabilizuar në llog.202 “Studime dhe kërkime”, prej 1,345,048,518 lekë, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, që në fakt i përkasin objekteve të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabël të Aparatit të MIE, por bashkive respektive.

- Nga auditimi i KLSH rezultojnë se në disa raste, llogaritë sintetike nuk kanë analizë inventariale, duke krijuar rrezikun mbi mbartjen pa asnjë analizë nga viti në vit, deri në humbjen e gjurmës së auditimit për këto vlera, për natyrën dhe origjinën se nga është mbartur kjo shumë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Gjatë kryerjes së procedurave analitike dhe testeve thelbësore, konstatohet se për disa poste të bilancit kontabël, llogaritë sintetike nuk kanë analizë inventariale për çdo Aktiv Afatgjatë Material (AAGJM) ose Jomaterial.

- Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje e terrene”, konstatohet se për vlerën prej 3,389,440 leke nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj, mungon analiza dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këtë aktiv.
- Gjithashtu për 3 pasuri trualli prej 186,080 m² me zonë kadastrale nr.8150, janë të regjistruara pa vlerë, trajtuar më hollësisht, në vijimësi.
- Nga auditimi i llogarisë 231 konstatohet se për dy aktive në vlerë 2,804,028,855 lekë mungon analiza e tyre si dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këto aktive pasi për aktivin në vlerë 269,377,038 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish-Ministria e Transportit dhe për aktivin në vlerë 2,534,651,817 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Energjisë.
- Llogaria kontabël nr.231 për aparatit e MIE ka shpenzime për rritjen e AAM në shumën prej 34,145,203 lekë pa adresim dhe analizë, nga 262 milionë që ka akumuluar kjo llogari, etj.;

Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk na u paraqit dokumentacion për analizën në mënyrë analitike dhe gjatë auditimi konstatohet se nuk është gjetur origjina se nga vjen dhe çfarë përfaqëson kjo shumë. Veprimi dhe mosveprimi nga ana e DF të Njësive Shpenzuese dhe DBMF në MIE është në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6, ku përcaktohet se:

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme konstatojnë në kontabilitetin e tyre të gjitha transaksionet ekonomike (monetare dhe jo monetarë) mbështetur në dokumentat financiarë, të cilët plotësojnë kërkesat minimale sipas nenit 4, pika 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Dokumentet financiare dallohen në:

-Dokumenta bazë justifikues që vërtetojnë shërbimin e kryer dhe/ose marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve të gjeneruara nga vetë NJQP ose të pranuar nga palë të treta (p.sh faturë blerje/shitje, fletë-hyrje/dalje, mandat-arkëtim/pagesë, situacion punimesh, procesverbale, etj), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike, dhe që shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.

-Urdhër-shpenzimi/Urdhër-pagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).

-Libra kontabiliteti, ditarë kontabilitetisi dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.

-Dokumenta të tjerë kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme.

Pretendimi i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se:

Pretendimi i subjektit: Për sa shpreheni në lidhje me disa llogari sintetike të cilat nuk kanë analizë inventariale, duke krijuar rrezikun mbi mbartjen pa asnjë analize nga viti në vit, deri në humbjen e gjurmës së auditimit. Për këto vlera, për natyrën dhe gjurmën së nga është mbartur kjo shumë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Nga auditimi i **Llogarisë 210 "Toka, troje e terrene"**, keni konstatuar se për vlerën 3,389,440 leke nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj, mungon analiza dhe MIE nuk disponon dokumentacioni Për këtë aktiv, ju sqaroj mesë vlera e aktivitet në këtë llogari është e mbartur nga bilancet e hershme të 3 ish Ministrive të cilat u bashkuan në MIE në vitin 2017, vetëm si vlerë dhe asnjë të dhënë tjetër, duke u mbartur të tilla në vazhdim.

Nga auditimi i **Llogarisë 231** keni konstatuar se për dy aktive në vlerë **2,804,028,855 leke** mungon analiza e tyre si dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këto aktive, ashta si dhe ju keni konstatuar janë vlera të mbartura nga bilancet e hershme të 3 ish Ministrive të cilat u bashkuan në MIE në vitin 2017, vetëm si vlerë dhe asnjë të dhënë tjetër, duke u mbartur të tilla në vazhdim.

Për pikën e fundit ku jeni shprehur **Llogaria kontabël nr.231** për aparatën e MIE ka shpenzime për rritjen e AAM në shumën prej **34,145,203 leke** pa adresim dhe analizë, nga 262 milionë që ka akumuluar kjo llogari, ju sqaroj mesë vlera e cituar në konstatimin tuaj është pjesë e analizës së Llogarisë 230 dhe jo Llogarisë 231, shprehur prej jush, dhe gjithashtu është nga bilancet e hershme të 3 ish Ministrive të cilat u bashkuan në MIE në vitin 2017, vetëm si vlerë dhe asnjë të dhënë tjetër, duke u mbartur të tilla në vazhdim. Referuar përcaktimeve më sipër, dhe faktit se Ministria e Infrastrukturrës dhe Energjisë është krijuar në vitin 2017, nga bashkimi i 3 ish-Ministrive, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka konstatuar në kontabilitetin e vet vlerat e transaksioneve mbështetur në informacionin e mbartur në librat e kontabilitetit, dhe pasqyrat financiare përkatëse të ish-ministrive, duke vepruar në përputhje me përcaktimet e udhëzimit sipërcituar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Obesrvacioni i paraqitur nga ana e MIE nuk merret në konsideratë pasi, ashtu siç jeni shprehur dhe keni konfirmuar dhe Ju me siper për disa nga aktivet e llogarisë 210, 230 dhe 231, mungojnë dokumentacioni justifikues dhe këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6.*

Observimi i paraqitur nga MIE është i njëjtë me atë të paraqitur mbi aktin e konstatimit për të cilin janë paraqitur qëndrimet në Projekt Raportin e dërguar zyrtarisht në MIE. Si pasoje, observacioni nuk sjell asnjë provë dhe dëshmi të re, ndaj nuk merret në konsideratë pasi këto veprime e mosveprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, mbi mënyrën e hartimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore.

Per sa sipër, gjetja do të vijojë të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të auditimit

8.Titulli gjetjes:	<i>Mos kontabilizim dhe mos identifikimi i vlerave të sakta dhe reale në kontabilitetin e njësisë shpenzuese MIE, të llogarisë inventariale "Toka, troje dhe terrene".</i>
---------------------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

<p>Situata:</p>	<p>Nga auditimi i llogarisë 210 konstatohet se për aktivin me vlerën prej 3,389,440 leke nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj, mungon analiza dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këtë aktiv. Gjithashtu dhe për 3 pasuri trualli prej 186,080 m² me zonë kadastrale nr.8150, janë të regjistruar pa vlerë.</p> <table border="1" data-bbox="523 427 1391 976"> <thead> <tr> <th colspan="7">Toka, Troje, Terrene (llogaria 210)</th> </tr> <tr> <th>Nr.</th> <th>Përshkrimi i aktivit</th> <th>ZK</th> <th>Nr.pas</th> <th>Njësia</th> <th>sasia</th> <th>Vlera e aktivit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Truall (prona nr.101 me emërtim depo ushqimit ish repart ushtarak)</td> <td>8110</td> <td></td> <td>m2</td> <td>16,470</td> <td>32,065,000</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Pa info nga bilanci MTI</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>3,389,440</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Truall</td> <td>8150</td> <td>1/540</td> <td>m2</td> <td>111,270</td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Truall</td> <td>8150</td> <td>1/064</td> <td>m2</td> <td>38,990</td> <td></td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Truall</td> <td>8150</td> <td>1/243</td> <td>m2</td> <td>35,820</td> <td></td> </tr> <tr> <td colspan="5">Totali i vlerës</td> <td>186,080</td> <td>35,454,440</td> </tr> </tbody> </table>	Toka, Troje, Terrene (llogaria 210)							Nr.	Përshkrimi i aktivit	ZK	Nr.pas	Njësia	sasia	Vlera e aktivit	1	Truall (prona nr.101 me emërtim depo ushqimit ish repart ushtarak)	8110		m2	16,470	32,065,000	2	Pa info nga bilanci MTI					3,389,440	3	Truall	8150	1/540	m2	111,270		4	Truall	8150	1/064	m2	38,990		5	Truall	8150	1/243	m2	35,820		Totali i vlerës					186,080	35,454,440
Toka, Troje, Terrene (llogaria 210)																																																									
Nr.	Përshkrimi i aktivit	ZK	Nr.pas	Njësia	sasia	Vlera e aktivit																																																			
1	Truall (prona nr.101 me emërtim depo ushqimit ish repart ushtarak)	8110		m2	16,470	32,065,000																																																			
2	Pa info nga bilanci MTI					3,389,440																																																			
3	Truall	8150	1/540	m2	111,270																																																				
4	Truall	8150	1/064	m2	38,990																																																				
5	Truall	8150	1/243	m2	35,820																																																				
Totali i vlerës					186,080	35,454,440																																																			
<p>Kriteri:</p>	<p><i>Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 35 dhe 36.</i></p>																																																								
<p>Ndikimi/Efekti:</p>	<p>Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në regjistrat kontabël.</p>																																																								
<p>Shkaku:</p>	<p>Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.</p>																																																								
<p>Rëndësia:</p>	<p>E lartë.</p>																																																								
<p>Rekomandimi:</p>	<p>-Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim identifikimin e aktivit që përfaqësojnë shumën e regjistruar në kontabilitet me emërtimin “Pa info nga Bilanci MTI” në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues.</p> <p>- Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e një grup pune me ekspertët e fushës për përllogaritjen së vlerave së tokës te cilat janë regjistruar në kontabilitet me emërtimin “ truall” dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.</p>																																																								

<p>9.Titulli gjetjes:</p>	<p><i>Mungesën identifikimi i zërave analitik në llogarinë 230 dhe 231.</i></p>
<p>Situata:</p>	<p>Nga auditimi i llogarisë 230 konstatohet se për aktivin me vlerën prej 34,145,203 leke nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj (gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria Energjetikës), mungon analiza për këtë vlerë dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këtë aktiv. Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 231</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

	konstatohet se për dy aktive në vlerë 2,804,028,855 lekë mungon analiza e tyre si dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këto aktive pasi për aktivin në vlerë 269,377,038 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Transportit dhe për aktivin në vlerë 2,534,651,817 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Energjisë.
Kriteri:	Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, në regjistrat kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<p>1.Nga ana e MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.</p> <p>2. Nivelet menaxheriale të MIE të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për identifikimin dhe vlerësimin e detajuar të cdo zëri të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit pune me qëllim identifikimin e aktiveve të llogarisë 230 dhe 231 që përfaqësojnë shumën e regjistruar në kontabilitet me emërtimin “ish Ministria e Transportit dhe ish Ministrisë së Energjetikës” në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues dhe të behet transferimi i tyre në llogarit kontabël përkatëse.</p>

- Evidentohet një nivel i lartë të drejtave për arkëtim dhe nivel i lartë i detyrimeve të pagueshme kundrejt subjekteve private dhe që ka patur trend në rritje për periudhën e audituar, përkatësisht.

- **Të drejtat e arkëtueshme**

Debitorët e ndryshëm (Ilog. 468) ishin në shumën prej 2,043 milionë lekë në vitin 2020, 4,209 milionë lekë në vitin 2021 dhe 4,694 milionë lekë në fund të v. 2022 si në tabelë:

2020	2,043,952,671
2021	4,209,350,220
2022	4,694,109,388

- **Detyrimet e prapambetura (Ilog. 486):**

Për aparatën e MIE, ishin në shumën prej 993 milionë lekë në vitin 2020, 1,305 milionë lekë në vitin 2021.

Në kuadër të konsolidimit të MIE, Ilog 486 paraqitet për 1,612,312,320 lekë më 31.12.2020 dhe më pas 1,966,810,355 lekë në fund të v. 2021 dhe më 31.12.2022 këto shuma pakësohen dhe bëhen 542,573,164 lekë.

2020	1,612,312,320
2021	1,966,810,355
2022	542,573,164



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Më hollësisht, të drejta për arkëtim në kontabilitetin e kësaj njësie shpenzuese (Aparati i MIE) janë të mbartura prej kohësh, me rrezik parashkrimi:

Në aktiv formatin nr.1, në llogaritë e kërkesave arkëtimi mbi debitorët janë pasqyruar “**Personeli, paradhënie, deficite e gjoba**” (Ilog. 423, 429) në vlerën **374,722 lekë** në fund të v.2021 e cila në analizë përbëhet kryesisht nga debitorë të viteve të kaluara (2015-2016) të ish-Ministrisë Industriale dhe Energjitike, për paradhënie të pa mbyllura:

- 1- P. B. për 28,755 lekë
- 2- B. V. për 8,440 lekë
- 3- A. J. për 3,150 lekë
- 4- G. P. për 17,025 lekë
- 5- G. Ç. për 7,150 lekë
- 6- E. Sh. për 68,521 lekë
- 7- Dh. K. për 127,610 lekë
- 8- I. C. për 97,858 lekë

dhe nga ish MTI për:

- 9- A. T. për 16,2580 lekë.

Më datën 31.12.2022, llogaria 423, 429 “Personeli paradhënie deficite e gjoba” është në vlerën 406,275.00 lekë, merr në debit të saj detyrimet e punonjësve ndaj MIE-s të konstatuara dhe konkretisht me analizë pasqyrohet sipas tabelës së mëposhtme:

NR	EMËRTIMI	CELJA 2022	SHTESA 2022	PAKËSIMET 2022	GJENDJA më 31.12.2022
1	PAJTIMBELLO	28,755			28,755
2	BASHKIM VLADI	8,710			8,710
3	ADI JASIMI	3,105			3,105
4	GENCI POJANI	17,025			17,025
5	GENCI CELO	7,150			7,150
6	EDMOND SHESHI	68,251			68,251
7	DHURATA KURTI	127,610			127,610
8	ILIR CIKO	97,858			97,858
9	ARGITA TOTOZANI	16,258			16,258
10	ENKELEJDA MUCAJ		13,136		13,136
11	ILIA GJERMANI		13,822		13,822
12	ORJONA JANKO		4,595		4,595
	TOTALI	374,722	31,553	-	406,275

Për sa më lart nuk ka praktikë njoftimi ose kërkesë arkëtimi për personat debitorë për paradhënie të pa kthyer.

Në llogaritë e kërkesave arkëtimi mbi debitorët janë pasqyruar “**Debitorë të ndryshëm**” (Ilog. 468) në vlerën **4,209,350,220 lekë më 31.12.2021**, (nga **2,043,952,671 lekë më 31.12.2020**) , shumë e cila në analizë përbëhet kryesisht nga debitorë të viteve të kaluar (2015 -2016) të MEI si:

1. Automjet i vjedhur në vlerën 1,550,000 lekë.
2. Firma Th. në vlerën 496,759 lekë.
3. Fima A.k. në vlerën 238,622 lekë.
4. Fima E. (634,000 USD + 629,000 USD) në vlerën 124,399,600 lekë.
5. D. (476,000 EURO) në vlerën 353,285,100 lekë.
6. Projekt 2000 në vlerën 1,036,800 lekë.
7. P. R. në vlerën 4,415,570 lekë.
8. E. B. në vlerën 1,330,000 lekë.
9. Z. Bank në vlerën 119,965 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Por, janë shtuar edhe të drejta të tjera për arkëtim, të tilla si “Divident i Albpetrolit” për 2,155,452,687 lekë; masa e dëmit sipas urdhrorit nr.313. datë 23.12.2020 “Për përfundimet e inspektimit financiar publik” për 7 zyrtarë, me nga 126,322 lekë/secili, masa e dëmit sipas urdhrorit nr.313. datë 23.12.2020 “Për përfundimin e inspektimit financiar publik”.

Për sa më lart nuk ka praktikë njoftimi ose procedura ligjore juridike për të arkëtuar vlerën nga subjektet debitorë.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në datën 31.12.2022 është në vlerën 4,694,109,388.00 lekë përbëhet nga debitorë të viteve të kaluara, nga ish Ministria e Energjisë dhe Industrisë, detyrimi për dividendin e pa derdhur nga ana e shoqërisë A. P, etj. Për vitin ushtrimor 2022 janë shtuar detyrimet e ***OSHEE Grup sha, për detyrimet e tarifës koncesionare, sipas kontratës koncesionare nr.5535/5, datë 24.10.2016 prej 1,495,990,439 lekë dhe pakësuar detyrimet për dividendin e paguar nga sha A. P, për vlerën 1 milionë lekë (nga 2,155 milionë lekë debitor).***

Përfshirja e llogaritjeve për detyrimet e OSHEE Grup sha për tarifë koncesionare të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et e dhëna me koncesion për periudhën 2016-2021, i përket një periudhe 5 vjeçare , gjë që nuk është në konformitet me parimet e të drejtave të konstatuara në kontabilitet.

Sa më sipër, kontabilizimi i këtij detyrimi është bazuar në Akt Konstatimin mbi saktësimin e detyrimit të datës 17.3.2022 të mbajtur në Sektorin e Financës në prani të znj. L. V dhe znj.E. M dhe përfaqësuesit të OSHEE, i cili nuk është identifikuar me emër dhe mbiemër dhe nënshkrim, (por që sipas pretendimeve dërguar me observacionet nga ana e NZ te MIE është z.I. Q, por mungon nënshkrimi i tij), ndaj ky është një akt i njëanshëm në kuadër të rakordimit të detyrimeve të ndërsjella.

Në pjesën e detyrimeve janë përfshirë dhe masat kundrejt kompanisë ***“I.T.E.T. Fier”***, për dublim vlerë situacioni, penalitete dhe mungese vlere deklarimi, sipas raportit të Inspektimit Financiar Publik. (Në tabelë, Llog 468, viti 2022)

NR	EMËRTIMI	CELJA 2022	SHTESA 2022	PAKESIME 2022	GJENDJA me 31.12.2022
1	Divident A.P	2,155,452,687		1,000,000	2,154,452,687
2	Automjet I vjedhur	1,550,000			1,550,000
3	Firma TH	496,759			496,759
4	Firma A.K	238,622			238,622
5	Essegeti 634000+629000 \$	124,399,600			124,399,600
6	D 476000	353,285,100			353,285,100
7	Projekt 2000	1,036,800			1,036,800
8	P.R	4,415,570			4,415,570
9	E.B	1,330,000			1,330,000
10	Z. bank	119,965			119,965
Masa e demit sipas Urdhri nr313, date 23.12.2020* Per përfundimin e inspektimit financiar publik per personat si me poshte		-			-
13	P. A	126,322			126,322
14	A. Sh	126,322			126,322
15	F. M	126,322			126,322
16	A. A	126,322			126,322
17	E. M	126,322			126,322
18	S. C	126,322			126,322
19	E.K	126,322			126,322
Masa e demit sipas Urdhri nr313, date 23.12.2020* Per përfundimin e inspektimit financiar publik per Shoqërinë Koncesionare "I.T.E.T Fier" sh.p.k		-			-
20	Inceneratori Fier -Dublim situacioni I dates 05.07.2017 me situacion nr.5 date 09.02.2017	14,760,228			14,760,228
21	Inceneratori Fier -Penalitet per taksen e ndikimit ne infrastrukture	7,223,502			7,223,502
22	Inceneratori Fier -Mungesa e edeklarimit prane organeve Tatimore	48,166,694			48,166,694
23	Detyrim I OSHEEE ndaj MIE	1,495,990,439			1,495,990,439
26	Gjohje/penalite per kontraten koncesionare nr.5535/5 date 24.10.2016		66,387,038		66,387,038
27	Njoftim per derdhje detyrimi OSHEE sha "Pagesa e tarifës koncesionare te prodhimit te energjise elektrike nga HEC"		419,372,131		419,372,131
TOTALI		4,209,350,220	485,759,168	1,000,000	4,694,109,388



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se:

Pretendimi i subjektit: Për sa shpreheni se për vlerën e pasqyruar në Llogarinë 423, 429 "Personeli, paradhënie, deficite e gjoba", në vlerën 374,722 lekë në fund të viti 2021, përbehet nga **debitorë të hershëm nga ish Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe ish-MTI për paradhënie të pa mbyllur**. Për sa shprehur nga ana juaj se Nuk ka praktikë njoftimi ose procedura ligjore Për te arkëtuar vlerën nga subjektet debitorë, ju sqarojmë se nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka ndërmarrë veprimet si vijon:

-Me shkresën nr.28/9 datë 28.09.2020 i ka kërkuar drejtorisë juridike informacion mbi ecurinë e proceseve gjyqësore për arkëtimin e detyrimeve të subjekteve.

-Me shkresën nr.6931 datë 30.09.2020, i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Tiranë Për informacion mbi praktikën e hetimit të automjetit të vjedhur.

Përfshirje e llogaritjeve për detyrimet e OSHEE Group sh.a për tarifën koncesionare të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et e dhëna me koncesion për periudhën 2016-2021, i përket një periudhe 5 vjeçare, gjë nuk është në konformitet me parimin e te drejtave të konstatuara në kontabilitet.

Për sa më sipër kontabilizimi i këtij detyrimi është bazuar në Akt-konstatimin saktësimin e detyrimit të datës 17.3.2022 të mbajtur në Sektorin e Financës në prani të znj. L. V dhe znj. E. M dhe **përfaqësuesit të OSHEE i cili është nuk është identifikuar me emër dhe mbiemër dhe nënshkrim**, dal ky është një akt konstatim i njëanshëm në kuadër të rakordimit të detyrimeve të ndërsjellat. Për sa konstatuar nga ana juaj, ju sqarojmë se:

Përfshirje e llogaritjeve për detyrimet e OSHEE për tarifën koncesionare për periudhën 2016-2021 është bërë në bazë të saktësimin këtij nga të dyja palët, konkretisht me shkresën nr.2674 date 17.03.2022 OSHEE dërgon vlerat e rakorduar për tarifën periudhës sipërcituar se bashku me tabelat përkatëse të detajuara për çdo vit deri më 31.12.2021, te konfirmuara me nënshkrimin e përfaqësuesit të OSHEE, I. Q. Mbi këtë bazë është mbajtur akt- konstatimi nga nëpunësi zbatues i Aparatit dhe specialistit përkatës të sektorit për qëllime të evidencës kontabile dhe jo qëllime të cilës ju i konsideroni të njëanshme.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Obesrvaconi i paraqitur nga ana e MIE nuk meret në konsideratë pasi, ashtu siç jeni shprehur dhe keni konfirmuar dhe Ju me siper, vetëm kërkesa e derguar për Departamentin Juridik nuk konsiderohet mjet për arkëtimin e të drejtave sidomos në kushtet e riskut të krijimit të të ardhurave të munguara, nga parashkrimi i tyre.

Edhe obsesionet mbi përfshirjen e llogaritjeve për detyrimet e OSHEE për tarifën koncesionare për periudhën 2016-2021 është kryer me shumë vonesë dhe në tejkalim të detyrimeve ligjore respektive. Për me tepër, vlera e kësaj tarife prej 1,496 ilion1 lek1 nuk ka asnjë ndyshim për gjithë vitin 2022, pasi paraqitet me të njëjtën vlerë si në çelje dhe në mbyllje të ushtrimit.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me percaktimet e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 12, pika 3, gjerat “g” dhe “gj”;

Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 19 dhe 20;

Udhëzimi nr.9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit” i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsiderat dhe nga ana e MIE duhet të ndermerren menjëherë veprimet e nevojshme për arkëtimin e të drejtave.

10.Titulli gjetjes:	<i>Domosdoshmëria e marrjes së masave, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët si dhe për shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni kundrejt të tretëve, veprime në papajtueshmëri me gerrat “g” dhe “gj”, neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.</i>
Situata:	Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve të subjekteve debitorë dhe klientëve dhe që ka patur trend në rritje për periudhën e audituar, Debitorët e ndryshëm (llog. 468) ishin në shumën prej 2,043 milionë lekë në vitin 2020, 4,209 milionë lekë në vitin 2021 dhe 4,694 milionë lekë në fund të v. 2022. Rezulton se janë shtuar edhe të drejta të tjera për arkëtim, të tilla si “Divident i A.p” për 2,155,452,687 lekë, (për të cilin janë arkëtuar vetëm 1 milionë lekë); masa e dëmit sipas urdhrit nr.313. datë 23.12.20202 “Për përfundimet e inspektimit financiar publik” për 7 zyrtarë, me nga 126,322 lekë/secili etj.
Kriteri:	✓ Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 12, pika 3, gerrat “g” dhe “gj”; ✓ Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 19 dhe 20; Udhëzimi nr.9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit” i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48.
Ndikimi/Efekti	Mundësi për mos arkëtimin e debitorëve duke kaluar afatet administrative, në saktësimin e vlerës së të drejtave dhe detyrimeve të sektorit publik si dhe rritje të detyrimeve si rezultat i mos likuidimit në kohë të furnitorëve.
Shkaku:	Mosrespektim dhe mos zbatim i kuadrit ligjor për debitorët dhe kreditorët.
Rëndësia:	E mesëm – lartë
Rekomandimi:	<ol style="list-style-type: none">1. Drejtuesit e MIE të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë dhe të marrin masave, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët pasi teprica e tyre ka arritur 4,694 milionë lekë në fund të v.2022 si dhe për shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni kundrejt të tretëve.2. Drejtuesit e MIE të sigurojë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.3. Nga organet Drejtuese të MIE të rivlerësohen llogaritë e njësisë ekonomike për shumave pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

- Mbi depozitimin e pasqyrave financiare nga institucionet e varesise se MIE

Nga auditimi i kryer nga ana e audituesve të KLSH-së, në lidhje me dorëzimin e këtyre pasqyrave financiare dhe masat e propozuara nga ana e strukturave përgjegjëse në AMA, rezultoi se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 209 dhe 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor (9,878,278 mijë lekë) është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:

- Llog. nr. 2092 “Amortizim studime dhe kërkime” i akumuluar gjithsej është = 527,772 mijë lekë. U kryen testimet, për të vlerësuar nëse janë llogaritur amortizim për AAJM, për llog 203, “Koncesione, patenta e te ngjashme” në grupin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2022 të MIE dhe rezultoi se amortizimi për këtë zë është shtuar 1,701,888 lekë.

Sa sipër, ka gjetur zbatim SKK nr. 5 të përmirësuar; “Një njësi ekonomike duhet të shpërndajë shumën e amortizueshme të një aktivi jo material në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Amortizimi për çdo periudhë do të njihet si një shpenzim, përveç nëse një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e kostos së një aktivi tjetër”.

- Amortizimi vjetor i Aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në formatin 7 është në vlerën 9,350,505 mijë lekë.

Sa sipër, kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 107, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale”, i përmirësuar, ku përcaktohet se: “Amortizimi është konstatimi kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezultoi nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të pakthyeshme (përfundimtare) për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre.

Paragrafit nr. 107: “Shpenzimet e amortizimit të AAM-ve dhe AAJM-ve, si dhe humbjet nga zhvlerësimi, paraqiten si zë më vete i formatit 1 të pasqyrës së performancës, si dhe në zërat përkatës të formatit 2, në varësi të funksioneve të aktiveve në njësinë ekonomike. Fitimet/humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të AAM dhe AAJM njihen në zërat “Shpenzime të tjera të shfrytëzimit”.

“Amortizimi i AAGJ-së” është shpërndarja periodike dhe sistematike e vlerës së amortizueshme të AQT apo AP, në përputhje me jetëgjatësinë e dobishme. Jeta e dobishme ka të bëjë me periudhën gjatë të cilit ky lloj aktivi pritet të përdoret nga njësi apo numri i produkteve ose të ngjashme që njësi pret të përfitojë nga përdorimi i këtyre lloj aktiveve.

Formati nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, pasqyra e konsoliduar MIE

Nr.	Nr.	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
Rreshti	Reference Llogarie		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
a	b	c										
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	2,446,226,578	322,130,917	2,124,095,661	617,288	206,143,138	6,942,735	6,441,419	2,439,901,131	527,772,739	1,912,128,392
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	2,413,586,578	309,352,484	2,104,234,094	0	204,441,250	6,942,735	6,441,419	2,406,643,843	513,292,418	1,893,351,425
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme	32,640,000	12,778,433	19,861,567	617,288	1,701,888	0	0	33,257,288	14,480,321	18,776,967

Burimi: MIE, DBMF, PFK Viti 2022

Në lidhje me regjistrimin e inventarit të plotë të aktiveve në SIFQ, u auditua procesi i migrimit të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, nga ku del se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Nga auditimi del se, *nga 15 institucione me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ deri në fund të vitit 2022, vetëm 11 prej tyre kanë migruar asetet e tyre fikse në SIFQ*, ndërkohë që, sipas tekstit të Strategjisë së MFP 2019-2022, aktivet publike të *gjashhtë institucioneve buxhetore janë hedhur në SIFQ që në vitin 2019* dhe se *“ka përfunduar transferimi i aktiveve publike për qeverinë vendore”*.

Deri në fund të v.2022 kanë migruar të dhënat e aktiveve në SIFQ këto institucione:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, AKSHI.

Janë 4 institucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e aseteve fikse në SIFQ, e më konkretisht:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** dhe Kryeministria.

MFE u është drejtuar disa herë këtyre institucioneve me shkresa zyrtare për përgatitjen e informacionit të aktiveve të tyre fikse, por këta informacione nuk janë dërguar në MFE, kjo për shkak të mungesës së saktësisë së gjendjeve të inventarit nga ana e këtyre institucioneve shtetërore, apo mungesës së të dhënave edhe si pasojë e procesit të bashkimit të disa institucioneve.

Në përfundim të procedurave të *kontrolleve kryqëzuese e verifikuese, si dhe kryerjes së testeve thelbësore mbi zërat e Bilancit Kontabël Përmbledhës/ Konsoliduar për MIE, analizuar dy vitet ushtrimore të njëpasnjëshëm 2022 dhe 2021, nga ku u konstatua se:*

- a) *Totali i Aktivit është i barabartë me totalin e Pasivit*, përkatësisht në shumën 432,510,083 mijë lekë për vitin kontabël të mbyllur më 31.12.2022 dhe në shumën 391,212,997 mijë lekë për vitin 2021;
- b) *Totali i Aktiveve Neto (F4, rreshti 20), janë të barabarta me shumën e Fondin e Konsoliduar* (rreshti 96 dhe 97 i pasqyrës së Pozicionit Financiar), përkatësisht prej 417,700,103 mijë lekë në vitin 2022 dhe 376,383,397 mijë lekë në vitin 2021.
- c) *Llogaria 63 “Ndryshimi gjendjes”, evidentuar në postin përkatës të pasqyrës së performancës financiare, (rreshti nr.130 në Pasqyrën F2 “Pasqyra e performancës financiare”), për institucionin e MIE, nuk rezulton të jetë e barabartë me ndryshimin e gjendjeve të llogarive të klasës së 3-të (midis vitit ushtrimor dhe ushtrimit të vitit të mëparshëm), në rreshtin nr.11, të Pasqyrës F1 “Pozicioni financiar”. Mospërputhja është – 71 mijë lekë, pasi teprica e llog.63 sipas F1 është - 6,651 mijë lekë në vitin 2022 (si efekt në shpenzime dhe diferencë e llogarive vjetore të klasës së tretë mbi gjendjen e inventarit, 179,655 mijë dhe 186,307 mijë lekë); dhe në vlerën prej - 6,578 mijë lekë në fund të vitit 2022 në F2 (rreshti 130), në mospërputhje me përcaktimet e paragrafit nr.24, aneksi nr.2 i Udhëzimit nr.5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.*
- d) Nga kryerja e testeve substantivë, për verifikimin e rrekordimit të tepricave në fund të periudhës tek Pasqyra F1 “Pasqyra e Pozicionit Financiar” dhe Pasqyra F7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (me vlerën e tyre neto), u konstatua se:
 - ✓ nuk ekzistojnë mospërputhje midis të dhënave të bilancit të mbylljes të vitit 2022 (në formatin 7/b, me ato të regjistruara në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Bilancit Kontabël”, në lidhje me të dhënat kontabël të bilancit të mbylljes më 31.12.2022 për **AAJM**, përkatësisht për 1,912,128 mijë lekë.

✓ Ekzistojnë mospërputhje midis të dhënave të bilancit të mbylljes të vitit 2022 (në formatin 7/b, me ato të regjistruara në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, në lidhje me të dhënat kontabël të bilancit të mbylljes më 31.12.2022 për **AAM**, Më konkretisht, **Aktivet Afatgjata Materiale më dt. 31.12.2022 në F1 janë pasqyruar për 182,171,229 mijë lekë dhe në Pasqyrën F7 janë 182,163,506 mijë dhe paraqesin diferencën ose mosrakovimin prej 7,723 mijë lekë.**

e) Sipas parashikimeve të Paragrafit nr.15, Aneksi nr.2, i Udhëzimit nr.5, datë 21.2.2022, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, evidentohet që totali i Aktiveve Neto/ Fondit të Konsoliduar, i evidentuar në pasqyrën e pozicionit financiar, (formati F1, rreshti 96, grupi C), është i barabartë me totalin e fondeve të veta të evidentuar në pasqyrën financiare të Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto (Formati F4, rreshti 20), përkatësisht për 417,700,103 mijë lekë në vitin 2022 dhe 376,383,397 mijë lekë në vitin 2021.

f) Evidentohet se, teprica e Llogarisë së Likuiditeteve, në fund të vitit ushtrimor (rreshti nr.34, i formatit F3, cash floë), janë pasqyruar përkatësisht për 6,610,541 mijë lekë në fund të vitit 2022 dhe për 7,197,760 mijë lekë më 31.12.2021, shifra këto që rakordojnë me Tepricën e grupit “Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre”, ku bëjnë pjesë Llogaritë e Likuiditeteve (llogaria 520, “Disponibilitete në Thesar”, etj). në rreshtin nr. 3 të Pasqyrës F1), të Pozicionit Financiar për PFK të institucionit të MIE.

Në auditimin e të dhënave të pasqyrës së performancës financiare në PFK të MIE rezultojnë që totali i të ardhurave gjithsej është i barabartë me shpenzimet plus pjesën e rezultatit, sa sipër kjo, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar. Kështu për vitin 2022, të ardhurat janë 8,108,946 mijë lekë, kurse shpenzimet 8,105,106 mijë lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej 3,839 mijë lekë përfaqëson rezultatin e veprimtarisë vjetore.

Kurse, për vitin 2021, të ardhurat janë 4,911,813 mijë lekë, kurse shpenzimet 4,917,056 mijë lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej -1,321 mijë lekë përfaqëson rezultatin e veprimtarisë vjetore. Nga ana tjetër u verifikua pasqyrimi për të njëjtën shumë të llogarisë 85 “Teprica ose deficit i periudhës” në pasqyrën nr.1 të pozicionit financiar (rreshti nr.100) dhe në rreshtin nr. 132, të pasqyrës së performancës financiare dhe për këtë vit nuk u konstatuan mospërputhje.

Në fakt, për vitin 2022 shuma e të ardhurave minus shpenzimet jep vlerën prej 3,839,858, (po aq sa pasqyron në fund të vitit, Pasqyra e Performancës Financiare, kurse evidentohen diferenca për vitin 2021 midis rezultatit të pasqyruar të llogarisë 85 (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve në F2), që nga llogaritjet del 5,242 mijë lekë (4,911,813,705 lekë - 4,917,056,582 lekë); dhe jo -1,321 mijë lekë sa paraqitet vlera në fund të kësaj tablele.

rreshti	Llogaria	PERSHKRIMI I OPERACIONEVE	Viti USHTRIMOR 31.12.2022	I MEPARSHEM 31.12.2021
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	8,108,946,510	4,911,813,705
74	B	SHPENZIMET	8,105,106,652	4,917,056,582
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDES (Rezultati i Veprimtarisë së vitit Ushtrimor)	3,839,858	-1,321,100

Burimi: MIE, DBMF, PFK viti 2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

11.Titulli gjetjes:	<p><i>1.Në lidhje me regjistrimin e inventarit të plotë të aktiveve në SIFQ, u auditua procesi i migrimit të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, ku rezultoi se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është pjesë e listës me 4 institucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e aseteve fikse në SIFQ.</i></p> <p><i>2. Mospërputhje e të dhënave të bilancit të vitit paraardhës me bilancin e çeljes së vitit ushtrimor, etj.</i></p>
Situata:	<p>1.Nga ana e MIE nuk janë kryer regjistrimet dhe procesi i migrimit të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është pjesë e listës me 4 institucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e aseteve fikse në SIFQ.</p> <p>2.Në përfundim të procedurave të kontrolleve kryqëzuese e verifikuese, si dhe kryerjes së testeve thelbësore mbi zërat e Bilancit Kontabël Përmbledhës/ Konsoliduar për MIE, analizuar dy vitet ushtrimore të njëpasnjëshëm 2022 dhe 2021, nga ku u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none">✓ ekzistojnë mospërputhje midis të dhënave të bilancit të mbylljes të vitit 2022 (në formatin 7/b, k me ato të regjistruara në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, në lidhje me të dhënat kontabël të bilancit të mbylljes më 31.12.2022 për <u>AAM</u>, Më konkretisht, <i>Aktivet Afatgjata Materiale më dt. 31.12.2022 në F1 janë pasqyruar për 182,171,229 mijë lekë dhe në Pasqyrën F7 janë 182,163,506 mijë dhe paraqesin diferencën ose mosrakordimin prej 7,723 mijë lekë.</i> <p>Në auditimin e të dhënave të pasqyrës së performancës financiare në PFK të MIE rezultoi që totali i të ardhurave gjithsej është i barabartë me shpenzimet plus pjesën e rezultatit, sa sipër kjo, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar. Kështu për vitin 2022, të ardhurat janë 8,108,946 mijë lekë, kurse shpenzimet 8,105,106 mijë lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej 3,839 mijë lekë përfaqëson rezultatin e veprimtarisë vjetore.</p> <p>Kurse, për vitin 2021, të ardhurat janë 4,911,813 mijë lekë, kurse shpenzimet 4,917,056 mijë lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej -1,321 mijë lekë përfaqëson rezultatin e veprimtarisë vjetore. Nga ana tjetër u verifikua pasqyrimi për të njëjtën shumë i llogarisë 85 “Teprica ose deficiti i periudhës” në pasqyrën nr.1 të pozicionit financiar (rreshti nr.100) dhe në rreshtin nr. 132, të pasqyrës së performancës financiare dhe për këtë vit nuk u konstatuan mospërputhje.</p> <p><i>Në fakt, për vitin 2022 shuma e të ardhurave minus shpenzimet jep vlerën prej 3,839,858, (po aq sa pasqyrojnë në fund të vitit, Pasqyra e Performancës Financiare, kurse evidentohen diferenca për vitin 2021 midis rezultatit të pasqyruar të llogarisë 85 (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve në F2), që nga llogaritjet del 5,242 mijë lekë (4,911,813,705 lekë - 4,917,056,582 lekë); dhe jo -1,321 mijë lekë sa paraqitet vlera në fund të kësaj table.</i></p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.</p> <p>Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti	<p>Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhëna të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, në regjistrat kontabël.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<p>1. Nga ana e MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korigjimin e sistemimit të tyre në pasqyrat financiare të ushtrimit që do të mbyllet më 31.12.2023. Pasqyrat financiare vjetore 2023, të përmbajnë një informacion më të plotë shpjegues, lidhur me pasqyrimin e sistemeve në llogari, pasi konstatohet mungesa e informacionit mbi shpjegimet e nevojshme për mospërputhjet e vlerave në disa llogari të bilancit kontabël.</p> <p>2. Nivelet menaxheriale të MIE të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, dhe të përfundojnë procesin e migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është pjesë e listës me 4 institucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e aseteve fikse në SIFQ.</p>

- Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formati 12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” është plotësuar, relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

12.Titulli gjetjes:	<i>Në një numër të konsiderueshëm të pasqyrave financiare të analizuar dhe testuara, ose nuk është hartuar relacioni shpjegues i bilancit, ose ky informacion është i cunguar dhe me mangësi.</i>
Situata:	Formati 12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” është plotësuar, relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar . Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë informacione shpjeguese për përdoruesit e ndryshëm të të dhënave të nevojshme për vendimmarrje.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me shënime shpjeguese



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

të pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënimet të japin përshkrime dhe zërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

- Nga kryerja e testeve substanciale, për verifikimin e mbartjes së tepricave në fund të periudhës tek ato në fillim periudhe (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, u konstatua se, ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes dhe atij të çeljes në vitin pasardhës, për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për Institucionin e Qeverisjes Qendrore, MIE, duke krijuar problem me pasaktësinë e informacionit kontabël dhe shtuar vështirësitë e konsolidimit në nivel grupi dhe më tej në nivel të qeverisjes së përgjithshme, pasi efekti i përgjithshëm i mosrakordimeve është për 4,676,301 lekë.

Konstatohet se, nuk përputhen të dhënat e kolonës “ushtrimi i mbyllur” (i bilancit të dates 31.12.2021, i pasqyruar për 391,217,673,910 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, i pasqyruar për 391,212,997,609), duke patur një diferencë mosrakordimi në vlerën prej - **4,676,301 lekë**, sa pasqyruar me pak çelje ushtrimi i mëparshëm, në fillim të vitit 2022.

Nga ana e institucionit “**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**” Tiranë, me shkresën nr. 4489 prot, datë 22.5.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 9365, datë 23.5.2023. Sa më sipër, konstatohet se depozitimi PFK është bërë me vonesë dhe nuk janë respektuar afatet e caktuar në UMF nr. 8/2018, ndryshuar me UMF nr.5/2022. Konstatohet se, në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) është i kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre, për 417,700,103 mijë lekë. Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” (rreshti nr. 100 i F1 për vitin 2021 është evidentuar për 3,403 mijë lekë dhe për v.2022 për 3,837 mijë, kurse në pasqyrën F1 “Pasqyra e performancës financiare”, (rreshti 136) vlerat e kësaj llogarie nuk përputhen me sa më sipër, pasi janë regjistruar përkatësisht për -1.321,mijë lekë dhe 3,839 mijë lekë (v.2022), duke rezultuar me mungesa kuadrimesh.

Nuk rakordon llogaria 63 e pasqyrës F2 me rezultatin e ndryshimit të gjendjes për klasën e tretë në pasqyrën F1 për vitin 2022. Më konkretisht,

✓ Referuar të dhënave të vitit 2021: llog 63 ne F2 “PPF” është e evidentuar për 24,573 mijë lekë, e cila është e rakorduar me të dhënat nga llogaritjet e ndryshimit të gjendjes ne F1 për gjendjet e inventarit qarkullues, (llog 31-39 te Aktivit te Bilancit), rezulton shuma 24,573 mijë lekë (186,307 mijë – 210,880 mijë).

✓ Referuar të dhënave të vitit 2022: llog 63 ne F2 “PPF” është e evidentuar për 6,578 mije, kurse nga llogaritjet e ndryshimit të gjendjes ne F1 për gjendjet e inventarit qarkullues, (llog 31-39 te Aktivit te Bilancit), rezulton shuma 6,652 mijë lekë (179,655 mije – 186,307 mijë). Pra, moskuardimi/mosperputhja është në shumën prej 74 mijë lekë.

Konstatohet se, nuk përputhen të dhënat e kolonës “ushtrimi i mbyllur” (i bilancit të dates 31.12.2021, i pasqyruar për 391,217,673,910 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, i pasqyruar për 391,212,997,609), duke patur një diferencë mosrakordimi në vlerën prej - **4,676,301 lekë**, sa pasqyruar me pak çelje ushtrimi i mëparshëm, në fillim të vitit 2022, në mospërputhje me përcaktimet e **paragrafit 31, pika 3.1,**”Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

"Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të **saktësojë regjistrimet kontabël** në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar në **pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara** për njësinë publike qendrore ose vendore, që përfshin të githa njësitë e varësisë dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi.

Më konkretisht:

- Në PFK të v.2021 të MIE, (të depozituara me nr. 7940/13 prot e MFE, dt 29.4.2022,
(të dhënat në Lekë):

emërtesa	v.2021 (ushtrimi i mbyllur)	v.2020 (ushtrimi i mëparshëm)
Shuma totale aktivitet-pasivitet	391,217,673,910	361,27,085,820

- Në PFK të v.2022 të MIE, (të depozituara me nr. 9365 prot e MFE, dt 23.4.2022,
(të dhënat në Lekë):

emërtesa	v.2022 (ushtrimi i mbyllur)	v.2021 (ushtrimi i mëparshëm)
Shuma totale aktivitet-pasivitet	432,510,083,764	391,212,997,609

Teprica në fund të periudhës e "Granteve të brendshme kapitale" (llog.105) në Pasqyrën nr.4 "Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto", përputhet me tepricën në fund të periudhës, të pasqyrës nr. 1 Pasqyra e pozicionit financiar", elementet e grupit D "Fondi i Konsoliduar", për vlerën e tyre prej 57,566,729 mijë lekë dhe nuk kishte pasaktësi.

U audituan barazimet e llogarive dhe rakordimi i informacionit financiar dhe vlerat e regjistruara të AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) për vitin 2021 dhe 2022 dhe krahasimet nëse përputhen vlerat e llogarive të AAJM dhe AAGJM me shumatat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ" (me vlerën neto), dhe rezultojnë se:

a.Në lidhje me AAGJJM nuk evidentorhen diferenca dhe paraqitet kjo situatë nga kryqezimi i të dhënave të informacionit kontabël:

Emërtesa	Pasqyra nr.1 Pozicioni Financiar (vlera neto e aktiveve afatgjata)	Pasqyra nr.7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata neto)	Diferencat/ moskuadrim
Shuma AAGJJM 31.12.2021	2,124,095,661	2,124,095,661	0
Shuma AAGJJM 31.12.2022	1,912,128,392	1,912,128,392	0

b) Konstatohet se **ekzistojnë mosrakordime për vlerën analitike të AAGJM në pasqyrat e ndryshme të llogaridhënies vjetore, për të dy vitet objekt auditimi, në mospërputhje me kërkesat e paragrafit 92, pikës 3.8.3** "Rregullat për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata", kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se,

"Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto) jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shitesat e pakësimit) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (materiale e jomateriale) me vlerën neto të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës. Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shitesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimit gjatë periudhës ushtrimore dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin.”

dhe paragrafi nr. 94 i këtij Udhëzimi:

“Totali i aktiveve afatgjata, për çdo zë të evidentuar në kolonat e pasqyrës, paraqitet në rreshtin e fundit të kësaj pasqyre. Gjendja e aktiveve afatgjata (të evidentuara në këtë pasqyrë), në çelje dhe në mbyllje të vitit ushtrimor, **duhet të kuadrojë** përkatësisht me totalin e zërave të aktiveve afatgjata jomateriale dhe aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar.”

ku ka rezultuar si më poshtë vijon:

(të dhënat në Lekë):

Emërtesa	Pasqyra nr.1 Pozicioni Financiar (vlera neto e aktiveve afatgjata)	Pasqyra nr.7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata neto)	Diferencat/ Mos kuadrimi
Shuma AAGJM 31.12.2021	176,474,068,200	176,466,330,650	7,737,550
Shuma AAGJM 31.12.2022	182,171,229,238	182,163,506,935	7,722,303

Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është kontabilizuar për 10,919,908 mijë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” ka të regjistruar tepricat debitore per cdo vit, përkatësisht prej 1,966,810,355 lekë në v.2021 dhe 542,573,164 lekë në v.2022.

Nga auditimi i pasqyrave financiare përmblendhëse për vitin 2021 dhe 2022 rezulton se nuk janë përfshirë në skemën e konsolidimit të MIE, së paku dy institucione: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit.

Nga ana e auditimit të KLSH është konstatuar se, PFV të AZHT për vitin 2022 janë dërguar në MFE me shkresën nr. 1453, datë 23.3.2023, (protokolluar në MFE me nr.2879/36, datë 31.3.2023) ku shuma gjithësej e aktivitetit dhe pasivitetit është 23,352 mijë lekë dhe këtu, pjesa e shpenzimeve të periudhave të ardhshme në bilanc janë më 31.12.202 për 1,179,903 lekë. Gjithashtu, PFV të AKPT për vitin 2022 janë dërguar në MFE me shkresën nr. 490, datë 24.4.2023, (protokolluar në MFE me nr.9090, datë 17.5.2023) ku shuma gjithësej e aktivitetit dhe pasivitetit është 177,873 mijë lekë dhe këtu, pjesa e shpenzimeve të periudhave të ardhshme në bilanc janë më 31.12.202 është zero lekë. Si rrjedhojë pjesa e aktiveve të konsoliduara nuk pasqyrojnë në mënyrë të saktë inventarin e aktiveve të sektorit publik.

Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyrën nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.

Nga ana e grupit të auditimit, u testuan disa zëra dhe nënlogari të grupit Aktivitet Afatgjata Materiale dhe më konkretisht:

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 35,454,440 lekë, vlerë e pa ndryshueshme nga viti i mëparshëm tabela si më poshtë:

“Toka, Troje, Terrene”, (llogaria 210)						
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	ZK	Nr. Pas	Njësia	sasia	Vlera e aktivitetit
1	Truall (prona nr.101 me emërtim depo ushqimit ish repart ushtarak)	8110		m2	16,470	32,065,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

2	Pa info nga bilanci MTI					3,389,440
3	Truall	8150	1/540	m2	111,270	
4	Truall	8150	1/064	m2	38,990	
5	Truall	8150	1/243	m2	35,820	
Totali i vlerës						35,454,440

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09.2023 shpreh se:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me mos akordimin e tepricave në fund të periudhës 2021 dhe mbartjen e tyre në vitin 2022, sqarojmë se ky mos akordim ka ardhur nga AKUM Për shkak se në vitin 2022 Për zërin mjete transporti vlera e hedhur në SIFQ prej 6.392.474 lekë është e gabuar, pasi në pasqyrat e dorëzuara në MIE dhe në Degën e Thesarit, kjo vlerë është 11.068.776 lekë. Gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2022, AKUM ka marrë si gjendje çelje Për zërin "mjete transporti", vlerën 6.392.474 lekë e cila ka sjellë mos akordimin Për diferencën prej 4.676.301 lekë. Pasi AKUM të bëjë korrigjimet përkatëse pranë Degës së Thesarit, do të dërgoje në MIE, pasqyrat e sakta e cila do të reflektohet në korrigjimin e bilancit të konsoliduar të MIE.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Observacioni i paraqitur nga ana e NZ të MIE nuk ka bazë ligjore dhe rrjedhimisht nuk merret në konsideratë. MIE duhet të kishte kerkuar kthimin mbrapsh të pasqyrave financiare vjetore me parregulsi, që nuk mund të perfshihen në skemen e konsolidimit, megjese deformat raportimin dhe pasqyrimin e drejte e te vertete te gjendjes ne institucionet e varesise diekte.

13.Titulli gjetjes:	<i>Mos rakordim vlerash në bilancin “ushtrimi i mbyllur” (të datës 31.12.2021), me të dhënat e bilancit “ushtrimi paraardhës”, (të datës 31.12.2022), për diferencën prej 4,676,301 lekë.</i>
Situata:	Konstatohet se, nuk përputhen të dhënat e kolonës “ushtrimi i mbyllur” (i bilancit të datës 31.12.2021, pasqyruar për 391,217,673,910 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, i pasqyruar për 391,212,997,609), duke patur një diferencë mosakordimi në vlerën prej - 4,676,301 lekë , sa pasqyruar me pak çelje ushtrimi i mëparshëm, në fillim të vitit 2022.
Kriteri:	Paragrafi 31, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se, “Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojë regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar në pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për njësinë publike qëndrore ose vendore, që përfshin të gjitha njësitë e varësisë dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë informacione shpjeguese për përdoruesit e ndryshëm të të dhënave të nevojshme për vendimmarrje.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<ol style="list-style-type: none">1. Nga MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e diferencave që kanë rezultuar në aktivet dhe pasivet, midis bilancit të mbyllur të vitit të mëparshëm dhe bilancit të çeljes për vitin ushtrimor, të kontabilizohet dhe paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara të MIE për vitin 2023, vlera e drejtë e Aktiveve të Afatgjata materiale e jo materiale, të drejtave dhe detyrimeve etj.2. Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të MIE, për vitin 2023.

Për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022, nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MIE, nuk evidentohet ndonjë rast i regjistruar, ku si pasojë e konstatimit të mosrakordimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Bilanci) në nivel grupi, t'i jenë kthyer institucionit buxhetor (ose organit qendror të saj), për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë ku nga, pasi është kontrolluar dhe me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga SIFQ, bazuar në informacionin kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësia qendrore, dhe referuar kërkesave të paragrafit nr. 23 dhe 24, të Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.2.2022, që përcakton se:

23.Në Kapitullin V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore", Paragrafi 120 ndryshon si më poshtë vijon:

Ministritë dhe institucionet e tjera qendore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar për pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të sapo mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, **Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakordimi i kthehet njësisë publike qendrore (organit qendror të saj) për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësia qendrore.**

24.Në Kapitullin V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore" Paragrafi 122 ndryshon si më poshtë vijon:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel njësie publike, respektivisht pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë atë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. **Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakordimi i kthehet njësisë publike vendore (organit qendror të saj) për zhurmim ne**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njëzia vendore.

14.Titulli gjetjes:	<i>Mos rakordim vlerash ne bilancin “ushtrimi i mbyllur” (dates 31.12.2021), me të dhënat e bilancit “ushtrimi paraardhës”, (datës 31.12.2022).</i>
Situata:	Për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022, nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MIE, nuk evidentohet ndonjë rast i regjistruar, ku si pasojë e konstatimit të mosrakordimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Bilanci) në nivel gupi, t'i jenë kthyer institucionit buxhetor (ose organit qendror të saj), për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë ku nga, pasi është kontrolluar dhe me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga SIFQ, bazuar në informacionin kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njëzia qendrore.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; Udhëzimi Nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë informacione shpjeguese për përdoruesit e ndryshëm të të dhënave të nevojshme për vendimmarrje.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	1.Për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022, nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MIE, nuk evidentohet ndonjë rast i regjistruar, ku si pasojë e konstatimit të mosrakordimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Bilanci) në nivel grupi, t'i jenë kthyer institucionit buxhetor (ose organit qendror të saj), për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë ku nga, pasi është kontrolluar dhe me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga SIFQ, bazuar në informacionin kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njëzia qendrore. 2.Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuara, të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të manualit të klasifikimit ekonomik kontabël, me qëllim për një pasqyrim dhe paraqitje të drejtë të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit si dhe të parandalohen gabimet materiale dhe parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare vjetore.

- Nga auditimi i llogarisë 210 konstatohet se për vlerën prej 3,389,440 leke nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj, mungon analiza dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këtë aktiv. Gjithashtu, për 3 pasuri trualli prej 186,080 m² me Zonë Kadastrale nr.8150, janë të regjistruar vetëm si sipërfaqe fizike, pa asnjë vlerë në kontabilitet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara

Llogaria 230 paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 343,225,690 lekë, vlerë e cila është rritur me 81,174,398 lekë nga viti i mëparshëm tabela si me poshtë:

NR.	EMERTIMI, LLOGARIA 230	VLERA 2021	VLERA VITI 2022	VLERA VITI 2022 BILANC
1	GJENDIA NGA VITET E KALUARA ISH MINISTRIA E ENERGJISE	34,145,203		34,145,203
2	FIN.HUA. GIZ 2015-2016	92,731,310		92,731,310
3	TVSH GIZ 2015	633,791		633,791
4	PAGESE TVSH GALET M064047 PROG 4320	16,689,369		16,689,369
5	PAGESE TVSH " PUBLICITA SHPK"	200,000		200,000
6	PAGESE KOSTO LOKALE " PUBLICITA SHPK"	1,000,000		1,000,000
7	PAGESE KOSTO LOKALE	98,800		98,800
8	ARCHISPACE - HARTIMI I PLANE VENDORE LOTI-4 SELENIC	30,189,400	3,266,600	33,456,000
9	GJEOKONSULT&CO HARTIMI I PLANEVE VENDORE LOTI I F. ARREZ	26,862,904	8,736,558	35,599,462
10, 11	ATELIER 4 SHPKHARTIMI I PLANEVE FAZA 0. GAIA - HARTIMI I PLANEVE VENDORE BASHKIA DEVOLL	23,711,734	6,758,786	30,470,520
12	DEA STUDIO SHPK HARTIMI PPV FAZA 1, 2, 3	28,199,724	2,399,755	30,599,479
13	PROJEKT PER RIKONSTRUKSIONI E GODINES (AAE)	672,000		672,000
14	6 D PLAN - AZHONRIMI PROJEKTIT MBYLLJA E GRYKA VE	960,000		960,000
15	GIZ- RIMBURSIMI I TVSH	2,562,160	1,359,226	3,921,386
16	OPONENC TEKNIKE	294,897		294,897
17	OPONENC TEKNIKE - MILOT BALLDREN	3,100,000	6,321,478	9,421,478
18	OPONENC TEKNIKE PROJEKT IDE DHE STUDIM FIZIBILITETIT TYNELI I LLOGARASE		14,067,589	14,067,589
19	PAGESE OPOONENC TEKNIKE STUDIM FIZIBILITETIT TYNELI I LLOGARASE		10,398,556	10,398,556
20	PAGESE OPOONENC TEKNIKE NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGORE TIRANE BA Y PASS		12,121,099	12,121,099
21	PAGESE OPOONENC TEKNIKE PROJEKTIMI, NDERTIMI, MIRMBAJTJA, TRANSFERIM AEROPORTI I VLORES		6,071,551	6,071,551
22	HARTIMI I PROJEKTIMIT TE STANDARTEVE TE NDERTIMIT TE SPITALEVE		9,673,200	9,673,200
	TOTAL	262,051,292	81,174,398	343,225,690

Burimi: MIE, DBMF, PFK 2022

Nga auditimi i llogarisë 230 konstatohet se për vlerën prej 34,145,203 leke nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës se saj (gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria Energjetikës), mungon analiza për këtë vlerë dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këtë aktiv.

Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

Llogaria 231 paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 35,819,165,244 lekë, vlerë e cila është rritur me 10,077,069,349 lekë nga viti i mëparshëm tabela si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

NR.	EMERTIMI, LLOGARIA 231	VLERA 2021	VLERA 2022	VLERA VITI 2022 BILANCI
1	GJENDJA NGA VITET E KALUARA ISH MINISTRIA E TRANSPORTIT	269,377,038		269,377,038
2	GJENDJA NGA VITET E KALUARA ISH MINISTRIA E ENERGJISË	2,534,651,817		2,534,651,817
3	RIMBURSIM TVSH KFW MAZARS PER INFRAS	8,551,372		8,551,372
4	RIMBURSIM TVSH PROG ZHVILLIMIT RAJONAL	2,129,158		2,129,158
5	CEZ RIMBURSIMI TVSH	3,244,815		3,244,815
6	ALBTEK ENERGY INCENERATORI ELBASAN	1,937,688,131		1,937,688,131
7	INCENERATORI FIER 06220.M064079	3,111,120,268	376,385,112	3,487,505,380
8	KONCESIONI MILOT-MORINE-SHERB KONSUL JM063842) PROG 4520	20,391,600		20,391,600
9	NDERTIM MONTIM PATOS TVSH QYTETI STUDENTI M 064049.PROG 43	85,100,137		85,100,137
10	NDERTIM MONTIM PATOS TVSH QYTETI STUDENTI	27,804,515		27,804,515
11	RIMBURSIM I KOSTOVE TE INFRASTRUKTURES ZEVENDESUESE	1,351,200,000		1,351,200,000
12	SYMBIOTICA SHPK-PAGES TVSH 04,04320, M064096	1,587,281		1,587,281
13	PAGESE TVSH KAP 04,04320.M064047	651,600		651,600
14	OPTIMA COMM PAGESE TVSH 04,04320.M064094	589,576		589,576
15	DEVOLL HYDROPOWER.04320 M064093	2,860,929,721		2,860,929,721
16	DOL.SAR SHERBIM KONSULENCE MILOT-MORINE	242,118,000	27,878,160	269,996,160
17	GALET-PAGESE TVSH RAP MUJH SHKURT	337,817		337,817
18	ENERGY ENV (EECC) PROJEKTI ENERJ 04320.3 (M064235).04 (M064095)	8,069,204		8,069,204
19	PUBLICITA SHPK-PROJEKTI M064235 ENERJ.TVSH M064095 (04320)	2,208,000		2,208,000
20	BAHAS-PAGUAR TVSH 04,04430.M064047	1,735,227		1,735,227
21	EDITERAN TRAVEL&TOURS-KOSTO LOKALE PER PROJEKTIN ENER	313,740		313,740
22	BAHAS SHPK-TVSH GALET (M 064047)KOSTO LOKALE GALET	6,628,711		6,628,711
23	HASTOCI SHPK-PAGESA MBYLLJA GRYKAVE TE MINIERAVE 04430	84,432,722		84,432,722
24	ALBANIAN HOGHWAY CONCESSION-MIREMBAJTJE MILOT-MORINE	518,211,443		518,211,443
25	HE&SKIL-SUPERVIZION PUNIMEVE MBYLLJE GRUKAVE	1,909,200		1,909,200
26	KOLAUDIM I PUNIMEVE PER MBYLLJEN E GRYKAVE	710,655		710,655
27	PROJEKTE PILOT PER RIKUALIFIKIMIN E BLOQEVË URBANE	15,000,000		15,000,000
28	SUPERVIZION PER RIKUALIFIKIMIN E BLOQEVË URBANE	600,322		600,322
29	KOLAUDIM PER RIKUALIFIKIMIN E BLOQEVË URBANE	131,641		131,641
30	SHERBIMET INXHINIERIKE TE PAVARURA PER ZBATIMIN E KONTRATES KONCESIONARE-PPP	127,507,062	70,159,998	197,667,060
31	ASISTENCE TEKNIKE *ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURES DIGITALE RAJONALE*	1,610,628		1,610,628
32	KOSTO LOKALE PER PROJEKTIN E QYTETIT STUDENTI NR.2	257,941	57,342	315,283
33	TVSH PROJEKTI GATE	668,466	23,782,382	24,450,848
34	KOSTO LOKALE SHERBIME TE TRASPORTI TE MALLRAVE QE LIDHIN OPERATORET SHPERN	8,500		8,500
35	MAZARS SHPK-TVSH, REHABILITIM I PORTIT TE VLORES	3,896,176		3,896,176
36	ENTINI COSTRUKZIONI SPA-TVSH.REHABILITIMI TE PORTIT TE VLO	17,162,255		17,162,255
37	ARCHISPACE-SUPERVISION APLIKIMI I TEKNIKES ME TE FUNDIT		536,290	536,290
38	ALBANIAN HIGHWAY CONCESSION-SUBVEBCION KONTRAT-MIREMBAJTJE MILOT-MORINE	1,720,258,020	740,978,280	2,461,236,300
39	SHERBIMET INXHINIERIKE TE PAVARURA E RRUGES ARBRIT-GR	487,609,501	34,016,987	521,626,488
40	KONTRATA KONCESIONARE/PPP PER PERMISIM,NDRT,OPERIM MIREMBAJTJE RRUGES ARBRIT	9,480,000,000	2,940,000,000	12,420,000,000
41	TVSH PER AUDITIMIN E PROJEKTIT GALET	117,449		117,449
42	TVSH I PROJEKTIT IPA	465,479	344,058	809,537
43	TVSH MNXH MBETJEVE TE NGURTA BERAT	15,374,757		15,374,757
44	SISTEMIM MEMO KREDI VITI 2020 (M064083)	-43,850		-43,850
45	TUNELI I LLOGARASE	700,000,000	5,512,819,605	6,212,819,605
46	SHERBIME INXHENIERIKE BYPASS ORIKUM-DUKAT	44,972,143		44,972,143
47	PAGESE PJESORE CB RAILWAY 18 BK001	1,720,000	3,153,589	4,873,589
48	PAGESE PJESORE INTERCONNCT 18BJ901	102,000	168,895	270,895
49	XHEKO IMPERIAL-04.04550.M064083	41,533		41,533
50	TRANSFERTE TVSH MBESHT SEKTORI EFICENSES ENERGJIS.BURIMEVE RINOVUESHME FONDI KOMB	5,498,514		5,498,514
51	RIMBURSIM TVSH QARKU BERAT	30,966,427		30,966,427
52	SYMBIOTICA SHPK-PAGES TVSH 04,04320, M064241	6,479,183		6,479,183
53	QYTETI STUDENTI NR.2 SHPK-PAGESE TVSH. 04320.M064242		10,451,233	10,451,233
54	PROJEKTIM NDERTIM MIREMBAJTJE PORTI I JAHTEVE BYE PASS ORIKUM DUKAT		224,698,533	224,698,533
55	SHERBIM KONSULENCE MILOT-MORINE 18BA216		23,257,200	23,257,200
56	SHERBIME INXHENIERIKE MBIQYRJE TUNELI LLOGARASE 20AC10		42,101,968	42,101,968
57	SHERBIME INXHENIERIKE TE PAVARURA E RRUGES SE ARBRIT-GR		40,337,559	40,337,559
58	PAGESE TVSH PROJEKTI REEHUB-19AC301		74,493	74,493
59	SH REHABILITIM I KONVIKTEVE TE UNIVERSITETI TIRANES 18BH		3,648,767	3,648,767
60	STUDIO ARCHIMED SHPK-PAGESE TVSH PROJEKTI I GAZSIELLESIT		721,298	721,298
61	SISTEMI INSTALIMIT QARKULLIMIT TE AJTIT NE MAGAZINE		1,497,600	1,497,600
	TOTALI	25,742,095,895	10,077,069,349	35,819,165,244

- Nga auditimi i llogarisë 231 konstatohet se për dy aktive në vlerë 2,804,028,855 lekë mungon analiza e tyre si dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këto aktive pasi për aktivin në vlerë 269,377,038 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Transportit dhe për aktivin në vlerë 2,534,651,817 lekë është gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Energjisë. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministris së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, paragrafi nr.35 dhe 36 dhe Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika nr. 6.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Pretendimi i subjektit Siç vihet re nga ana juaj është kërkuar Llogaria 230 dhe 231 analitike Për vitet 2021 dhe 2022 në tabelë Excel dhe është dërguar formati Excel i cili përmban detajimin e investimeve të përfshira në secilën llogari, në vlerat dhe shitesat përkatëse të shpenzimeve të konstatuara për këto investime për secilin nga vitet e kërkuara. Jeni shprehur gjithashtu në vazhdimësi për llogarinë 231, se në fund të vitit 2021 gjendja sipas bilancit për llogarinë 231 është 25,742,095,895 ndërkohë që nga llogaritja e grupit të auditimit vlera duhet të ishte 25,742,183,595 ose 87,700 lekë më tepër. Në lidhje me konstatimin tuaj, pas verifikimit dhe krahasimit të tabelës analitike të paraqitur nga ana juaj me tabelën analitike të pasqyruar në dosjen e bilancit nga ana jonë, ju sqarojmë se ka një paraqitje të gabuar nga ana juaj për vlerën 43,850 lekë, e cila është paraqitur në vlerën pozitive 43,850 lekë, por konkretisht në tabelën pjesë integrale të dosjes së bilancit të vitit 2021 është në vlerë negative (-43,850 lekë) pasi pasqyron një memo-kredi të një shpenzimi për një investim të kryer në vitin 2020 dhe të kthyer në vitin 2021.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Duke ju referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve tuaja Observacioni juaj meret në konsideratë dhe reflektohet në tratin në raportin perfundimtar të auditimit.*

- **Inventarizimi i pasurisë:**

Nisur nga rëndësia dhe *materialiteti sasior dhe në natyrë* të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2022.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën 2021-2022 çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr.74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar që sanksionin se: "Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të **paktën një herë në vit** ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materialë, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës" dhe neni 31, citohet " ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës..."

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja e aktiveve për çdo rastë dokumentohet me flete hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Më konkretisht:

Procesi i inventarizimit të aktiveve, **për vitin 2021-2022** është kryer nga disa komisioni të ngritur sipas urdhrat të Titullarit të Institucionit "Për krijimin e komisionit të inventarizimit"

Për vitin 2021:

Në zbatim të urdhrat të Ministrit nr.9135 prot datë 20.12.2021 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktiveve qarkulluese në ruajtje (Magazina)".

Komisionit të Inventarizimit i është ngarkuar të verifikojë inventarizimin fizik kushtet e ruajtjes, gjendjen fizike dhe vërejtjet.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrat kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MF me nr.30/2011, ku përcaktohet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

“Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar një relacion mbi inventarin fizik të aktiveve të vitit 2021 me shkresë nr.9135/3 prot datë 24.01.2022 në lidhje me rezultatet e nga ku rezultojë se nuk ka diferenca të gjendjes fizike me atë kontabël.

Për vitin 2022:

Në zbatim të urdhërit të Ministrit nr.9615 prot, datë 15.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktiveve qarkulluese ne ruajtje (Magazina)”.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar një relacion mbi inventarin fizik të aktiveve të vitit 2022 me shkresë nr.9615/2 prot datë 23.01.2022 në lidhje me rezultatet e nga ku rezultojë se nuk ka diferenca të gjendjes fizike me atë kontabël.

Me shkresë nr.8856 prot datë 09.12.2021, i ndryshuar me shkresë nr.9131 prot datë 20.12.2021, Ministri ka ngritur komisionit për asgjësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të aparatit të MIE të vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve i ngritur me urdhër nr.274 datë 25.09.2020.

- Me proces-verbal nr.1, 9131/1 prot datë 28.12.2021, komisioni ka bërë ndarjen e listës së aktiveve, të cilat mund të asgjësohen në landfill dhe ato të cilat nuk mund të asgjësohen në landfill siç janë kompjutera servera dhe pajisje të ndryshme IT.
- Me proces-verbal nr.2, 9132/2 prot datë 07.03.2022, komisioni ka kryer procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë duke i asgjësuar. Sa më sipër janë bashkëngjitur fatura e inceneratorit dhe foto e aktiveve të asgjësuar.
- Me proces-verbal nr.3, 9132/3 prot datë 10.03.2022, komisioni në përgjigje të Agjensisë Kombëtare të Mjedisit, i ka dërguar shkresa 3 kompanive për të bërë vlerësimin dhe propozimin ekonomik për pajisjet e vlerësuara për tu nxjerr nga përdorimi siç janë kompjutera servera dhe pajisje të ndryshme IT.

Me shkresë nr.31/1 datë 31.01.2023 komisioni i asgjësimit dhe sektorin e shërbimeve, pesha totale e pajisjeve elektronike është 4,000 kg. Për të kryer këtë shërbim vlera monetare përafërsisht është 95 leke/kg * 4,000 kg = 380,000 leke, duke u bazuar te çmimet e tregut që janë 95- 98 leke/kg.

Komisioni ka kërkuar vijimin dhe shqyrtimin e procedurës nga sektori i Prokurimeve.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin dërguar me shkresën nr. 6406/1, date 04.09.2023, protokolluar me nr. 360/10, datë 06.09.2023 vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 07.09. 2023 shpreh se:

Pretendimi i subjektit Bashkëlidhur gjeni fotot e asgjësimit të aktiveve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Duke ju referuar dokumentaciont dhe shpjegime tuaja Observacioni juaj meret në konsideratë dhe pasqyrohet në trajtimin në raportin përfundimtar të auditimit.

• **Tejkalimi i afatit 30 ditë të likuidimit të faturave:**

Nga auditimi me zgjedhje të urdhër-shpenzimeve, u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 184, që ka përcaktuar se:

“Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), *parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit*”, Tejkalmi i këtij afati ka krijuar detyrime të prapambetura për institucionin, ku sipas VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/ marrëveshje/ vendim gjykatë të formës së prerë, që mbeten të papaguara 60 ditë, pas datës së lëshimit të faturës nga operatori ekonomik.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ndikon në riskun e realizimit të investimeve të reja, si dhe blerjen e mallrave dhe shërbimeve të planifikuara, për t’u realizuar në periudhat e ardhshme, pasi një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga institucioni.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ka ardhur, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e si më poshtë:

- *Mos identifikimit të risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;*
- *Mosrespektimit të qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.*

Sa më lartë, vepruar në kundërshtim me përcaktimet e UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 184: Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7; VKM- nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”

Numri dhe data e urdher- shpenzimeve		Data e Fatures se dorezuar nga subjekti	Vlera totale (lekë)
563	18.11.2021	31.07.2021	50,640
564	18.11.2021	31.07.2021	50,640
568	23.11.2021	30.09.2021	243,600
580	24.11.2021	30.09.2021	59,040
582	24.11.2021	30.09.2021	32,184
607	06.12.2021	29.10.2021	89,500
730	29.12.2021	15.11.2021	728,500
731	29.12.2021	05.11.2021	799,200
748	30.12.2021	21.10.2021	7,119,934
759	30.12.2021	21.06.2021	211,400
760	30.12.2021	22.07.2021	84,838
762	30.12.2021	22.07.2021	21,130
765	30.12.2021	17.11.2021	120,000
Total			9,610,606

15.Titulli gjetjes:	<i>Mbi tejkalmimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave.</i>
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkalmuar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik” , si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a),



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

	parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit”.
Kriteri:	UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184: Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 ‘Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme.
Ndikimi/Efekti	Mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura.
Shkaku:	Shkelje e disiplinës buxhetore.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

Në përfundim për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi:

1.a. Për periudhën objekt auditimit, rezulton se në 10 raste, institucionet buxhetore të analizuara, kanë shfaqur probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale, nga institucionet buxhetore dhe ekstra-buxhetore, dhe më konkretisht:

✓ **Për vitin 2021**, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes qendrore MIE, ose afro 33 % e tyre, kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, me tejkallim dhe shkelje të afatit ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij, *përkatësisht, këto institucione për v.2021:*

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve & Infrastruktura se Mbetjeve Tiranë, Agjencia Kombëtare Bërthamore Tiranë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Qendra e Grumbullimit, Trajtimin të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan.

✓ **Për vitin 2022**, evidentohet se 5 (pesë) njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 15 institucione të përfshira në konsolidimin e llogarive nga ana e institucionit të qeverisjes



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

qendrore MIE, ose afro 33 % e tyre, kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore, pranë Ministrisë së Linjës Administrative, MIE, në institucionet e mëposhtme për v.2022:

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, Qendra e Grumbullimit, Trajtimin të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Agjencia Kombëtare Bërthamore;

në tejkalim e shkelje të afateve ligjor të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.
- Paragrafët nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018 dhe paragrafit nr.23, të UMF nr.5, datë 21.2.2022, pasi nuk është respektuar afati për depozitimin e PFK për vitin 2021 dhe 2022.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

1.1. Rekomandimi:

Nga ana e strukturave përgjegjëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të merren masat për zbatimin me përpikmëri të afateve kohore të përcaktuara në kuadrin rregullator mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar, duke administruar, sipas afateve ligjore të miratuara, pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, individuale dhe përmbledhëse nga të gjithë institucionet e sektorit publik të varësisë direkte.

Afati: Në vijimësi.

2.Gjetje nga auditimi:

Njësitë e Zbatimit të Projekteve të MIE nuk kanë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë MIE dhe MFE-së për v.2021 dhe 2022. Mos përfshirja në konsolidimin e organit qendror të njësisë, i informacionit financiar dhe i pasqyrave financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore, është veprim në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, Paragrafi nr. 20, shkronja “c”, i cili ka parashikuar se:

“Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjanuar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:

.....

c. Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

2.1. Rekomandimi:

Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ato të Njësive të Zbatimit të Projekteve, të marrin masat dhe bashkërendojnë veprimet me MFE për të korigjuar këtë parregullsi në vijim, si dhe të zbatojnë me përpikmëri kriteret mbi hartimin, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare nga NJZP dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore MIE, me qëllim përfshirjen e tyre të plotë në sistemin e raportimit financiar publik dhe në pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel grupi.

Afati: Në vijimësi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

3.Gjetje nga auditimi:

Mos përfshirja në setin e pasqyrave të konsoliduara e të gjitha institucioneve që shtrihen brenda fushës së përgjegjësisë së Ministrisë, të kërkuara sipas kuadrit ligjor.

Nuk janë përfshirë në pasqyrat e konsoliduara, të dhënat e institucionit të Agjencise Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), pasi në Nenin 3 “Përkufizime”, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nënvizohet se, “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)” është institucion me përgjegjësi planifikimi në kuadër të **ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**” si dhe më tej në Nenin 8 “Përgjegjësitë e ministrisë së linjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të po këtij ligji.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandimi:

Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të saktësojnë numrin e institucioneve shpenzuese buxhetore dhe ekstra-buxhetore, që kanë detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore, me qëllimin e konsolidimit financiar e kontabël, si dhe përmbledhjen e informacionit financiar të organit qendror të njësisë (aparati), me të gjitha njësitë e varësisë/ institucionet shpenzuese dhe kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore MIE.

Afati: Në vijimësi.

4.Gjetje nga auditimi:

Për mos dorëzimin apo dorëzimin jashtë afatit ligjor të pasqyrave financiare individuale nga ana e njërive shpenzuese/ institucioneve shtetërore buxhetore apo ekstra-buxhetore etj., nuk është kërkuar marrja e masave disiplinore e administrative nga ana e drejtuesve të MIE apo nga Nëpunësi i Parë Autorizues. Më hollësisht, evidentohet se:

Për vitin 2021:

-Dorëzimi i PFK nga ana e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, është bërë me datën 12.4.2022, ose 12 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;

-Dorëzimi i PFK nga ana e Agjencisë kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve & Infrastrukturës së Mbetjeve Tiranë, është bërë me datën 28.4.2022;

-Dorëzimi i PFK nga ana e Agjencia kombëtare Bërthamore Tiranë, është bërë me datën 13.4.2022, ose 13 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;

-Dorëzimi i PFK nga ana e subjektit Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është bërë me datën 12.4.2022, ose 12 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;

-Dorëzimi i PFK nga ana e Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan, është bërë me datën 11.4.2022, ose 11 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre.

Për vitin 2022:

-Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë”, nuk janë dorëzuar PFK e viti 2022;

-Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare Bërthamore Tiranë”, nuk janë dorëzuar PFK e viti 2022;

-Dorëzimi i PFK nga ana e subjektit Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë 24.4.2023 dhe protokolluar në MIE me datën 5.5.2023, ose 35 ditë në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

shkelje të afatit ligjor për depozitim e tyre;

-Dorëzimi i PFK nga ana e Qendrës së Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan është bërë me datën 12.4.2023, ose 12 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitim e tyre;

-Dorëzimi i PFK nga ana e Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është bërë me datën 5.5.2023, ose 35 ditë në shkelje të afatit ligjor për depozitim e tyre.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e:

- Nenit 71, germa ”e“, Kreu IX, të ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, që thekson (citojmë):

“Kur nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme nuk përmbushin detyrimet për mbylljen e vitit buxhetor dhe nxjerrjen e llogarive vjetore të buxhetit, në kundërshtim me nenin 62 të këtij ligji, dënohen nga nëpunësi i parë autorizues me masë administrative ose me gjobë në masën 1-3 paga mujore.”

- Paragrafit nr. 45, Kreu V, të Udhëzimit nr.25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, ku është shprehur se, (citar):

“Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësit autorizues dhe zbatues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar”,

- Paragrafit nr. 45, Kreu VI “Masat administrative”, të Udhëzimit nr.34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022, (citar):

“Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

4. Rekomandimi:

4.1. Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të merren masat për të administruar sipas afateve ligjore të miratuara, pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore individuale, në afat nga të gjithë institucionet e sektorit publik.

4.2. Nga ana e MIE të drejtohet dhe monitorohet procesi i konsolidimit dhe rakordimit të informacionet kontabël dhe gjendjet/ tepricat e llogarive si dhe realizimit të procesit të eliminimit të dublikimeve, përmbledhjes dhe konsolidimit në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, për institucionet e sektorit publik në varësi.

4.3. Për të gjitha rastet e mosrespektimit të këtyre afateve nga ana e institucioneve përgjegjëse, të kërkohet nga ana e drejtuesve të MIE apo nga Nëpunësi i Parë Autorizues zbatimi i sanksioneve të parashikuara ligjore, si kundrejt titullarëve të institucioneve shtetërore, ashtu edhe ndaj nëpunësve autorizues dhe zbatues përkatës, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Afati: Në vijimësi.

5.Gjetje nga auditimi:

Nuk është regjistruar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të periudhës 2021- 2022 vlera e trojeve në administrim të institucionit, të cilat ndikojnë në cilësinë e kontabilitetit dhe pasqyrimit me vërtetësi e saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël në shumë institucione publike. Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2021, llogaria nr. 210 “Toka, troje e terrene” është në vlerën zero lekë dhe nuk janë regjistruar këto sipërfaqe toke në kontabilitetin e njësisë shpenzuese buxhetore, ndonëse sipas VKM përkatëse, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objekteve ndërtimore dhe truallit, për llogari të këtyre institucioneve. Kjo çështje për grupin e auditimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (hartat sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet duke filluar nga çmimi 66,969 lekë/m² për këto zona kadastrale. Kjo parregullsi është evidentuar në institucionet e mëposhtme: Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial, Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor Durrës, Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës, Instituti Transportit Tiranë, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë, etj. (Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

5.1. Rekomandimi:

Të merren masat nga NA dhe NZ i MIE, që të kërkojnë nga Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të njëjsteve shpenzuese, buxhetore e ekstra-buxhetore dhe Degët e Thesarit sipas juridiksionit dhe të marrin masa për vlerësimin, regjistrimin dhe evidentimin e saktë të gjendjes së llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" në kontabilitet, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vlera e tokës truall nën objektet e ndërtesave të pasqyruara në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione", si dhe vlera e trojeve dhe terreneve, të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave u janë kaluar në pronësi të institucioneve shtetërore, etj.

Afati: Në vijimësi.

6.Gjetje nga auditimi:

Nga analiza e pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) rezulton se për vitin 2020 dhe 2021, hartuesit e pasqyrave individuale të llogaridhënies vjetore të institucioneve shpenzuese, nuk kanë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ***për kryerjen e veprimeve kontabile sistemuese në lidhje me llogarinë nr. 4864, "Shpenzime të periudhave të ardhshme"***, ku përcaktohet shprehimisht se: ***"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31 Dhjetor 2021. Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara"***.

Teprica debitore e Llog.486 "Shpenzimet e periudhave të ardhshme", sipas PFK të MIE për vitin 2021 është evidentuar (për ushtrimin e mbyllur me dt.31.12.2021) në vlerën **1,966,810,355 lekë**, shumë kjo e mbartur me korrektesë në çelje të PFK të vitit 2022, dhe për vitin 2022 teprica e kësaj llogarie është **542,573,164 lekë**. **Pra, nuk rezulton të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 468.** Sa më sipër, analiza e pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) tregon se, për vitin 2020, 2021 dhe 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në shumicën e institucioneve buxhetore të vartësisë, nuk janë hartuar në përputhje me përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me **llogarinë nr. 4864, "Shpenzime të periudhave të ardhshme"**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Më hollësisht,

Të dhënat në lekë

Nr	Emërtimi i institucionit buxhetor	31.12.2021
1.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Tiranë	133,711,658
2.	Instituti Transportit Tiranë	0
3.	Drejtorja e Përgjithshme Detare Durrës	0
4.	Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor Durrës	
5.	Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil Tiranë	0
6.	Agjencia kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë.	494,647,742
7.	Agjencia Kombëtare Bërthamore	0
8.	Agjencia e Eficiencës së Energjisë	33,258,089
9.	Sherbimi Gjeologjik Shqiptar	0
10.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Minier	60,000
11.	Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial	0
12.	Qendra e Grumbullimit, Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan	0
13.	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	0
14.	Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve	0
15.	Aparati MIE	
	Shuma	1,966,810,355

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për të monitoruar zbatimin e normave teknike dhe ndjekë procesin e sistemeve në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në kundër partinë e saj, llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për pasqyrat financiare të ushtrimit që do të mbyllet më 31.12.2023, meqenëse llogaria 486 si llogari e pozicionit financiar luan rolin e një llogarie teknike për identifikimin e detyrimeve të prapambetura.

Afati: Në vijimësi.

7.Gjetje nga auditimi:

7.a. Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar nga VKM dhe kaluar në përgjegjësi administrimi të ministrisë dhe subjekteve të varësisë direkte;

7.b. Përfshirja e vlerës e planeve të përgjithshme vendore, pjesë e llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 1,345,048,518 lekë, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore.

Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021 dhe më 31.12.2022, Aktivitet Afatgjatë Materiale pasqyrojnë edhe vlera të investimeve për rikonstruksioneve të kryera në objekte që nuk i përkasin MIE, por objekteve të tjera që ky institucion ka patur në përdorim të përkohshëm, përgjithësisht kjo e lidhur me objekte ndërtimore të ish-ministrive që i janë bashkuar MIE, si dhe AAJM të cilat nuk janë transferuar, të tilla si:

- ✓ Rikonstruksioni i kryer për Zyrat e Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimi, që rezulton në PF të Aparatit të MIE;
- ✓ Vlera e planeve të përgjithshme vendore, pjesë e llog.202 “Studime dhe kërkime”, prej 1,345,048,518 lekë, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore. Planet e Përgjithshme Vendore i përkasin objekteve të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabël të Aparatit të MIE, dhe që u përkasin bashkive respektive.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Nga ana e MIE gjatë vitit 2021 nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprimet për transferimin dhe sistemin e tyre kontabël sipas ligjit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

7. Rekomandimi:

7.1. MIE, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për saktësimin e analizës së llogarive dhe të bëjnë korrigjimet dhe sistemimet e domosdoshme, që në këtë llogari të aktiveve afatgjata materiale të paraqitet vlera e drejtë e tyre dhe e rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.

7.2. Nga ana e MIE gjatë vitit 2021 të merren masat për transferimin e vlerës së planeve të përgjithshme vendore, kontabilizuar në llog.202 “Studime dhe kërkime”, prej **1,345,048,518 lekë**, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, që në fakt i përkasin zërave, të cilat nuk janë pjesë e aktiveve të sistemit kontabël të Aparatit të MIE, por e bashkive respektive.

Afati: Në vijimësi.

8.Gjetje nga auditimi:

Nuk janë kryer kontabilizimet dhe identifikuar vlerat e sakta dhe reale , të llogarisë inventariale “Toka, troje dhe terrene”, në kontabilitetin e njësisë shpenzuese Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Nga auditimi i llogarisë 210 për aparatit të MIE, rezultoi se për aktivin e saj “tokë truall” me vlerën prej **3,389,440 lekë**, nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj. Pra, mungon analiza dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këtë aktiv. Gjithashtu, edhe për 3 (tre) pasuri trualli me sipërfaqe prej 186,080 m² në zonën kadastrale nr.8150, të dhënat në kontabilitet janë të regjistruar pa vlerë.

Toka, Troje, Terrene (llogaria 210)						
Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	ZK	Nr.pas	Njësia	Sasia	Vlera e aktivitetit
1	Truall (prona nr.101 me emertim depo ushqimit ish repart ushtarak)	8110		m2	16,470	32,065,000
2	Pa info nga bilanci MTI					3,389,440
3	Truall	8150	1/540	m2	111,270	X
4	Truall	8150	1/064	m2	38,990	X
5	Truall	8150	1/243	m2	35,820	X
Totali i vlerës					186,080	35,454,440

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

8. Rekomandimi:

8.1. Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim identifikimin e zërave të aktiveve që përfaqësojnë shumën e regjistruar në kontabilitet me emërtimin “Pa informacion nga bilanci MTI”, në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të rregull vërtetues.

8.2. Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me ekspertët e fushës për përlllogaritjen e vlerave të tokës, të cilat janë regjistruar në kontabilitet me emërtimin “Truall”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Afati: Në vijimësi.

9.Gjetje nga auditimi:

Mungesë identifikimi i zërave analitik i investimeve në llogaritë inventariale 230 dhe 231.

Nga auditimi i llogarisë 230 konstatohet se për vlerën prej **34,145,203 lekë** nuk ka ndonjë të dhënë përveç vlerës së saj (*gjendje nga vitet e kaluara ish Ministria e Energjetikës*), si dhe **mungon analiza për këtë vlerë** dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këtë aktiv.

Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 231 konstatohet se për dy aktive në vlerë **2,804,028,855 lekë mungon analiza e tyre** dhe MIE nuk disponon dokumentacioni për këto aktive, pasi për aktivin në vlerën prej **269,377,038 lekë** është gjendje nga vitet e kaluara ish-Ministria e Transportit dhe për aktivin në vlerë **2,534,651,817 lekë** është gjendje nga vitet e kaluara ish-Ministria e Energjisë.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

9. Rekomandimi:

9.1. Nga ana e MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

9.2. Nivelet menaxheriale të MIE të forcojnë kontrollin në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për identifikimin dhe vlerësimin e detajuar të çdo zëri të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim identifikimin e analizës së llogarisë 230 dhe 231 që përfaqësojnë shumën e regjistruar në kontabilitet me emërtimin “*ish Ministria e Transportit*” dhe “*ish Ministrisë së Energjetikës*”, etj., në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të plotë vërtetues dhe të behet transferimi i tyre në llogaritë kontabël përkatëse.

Afati: Në vijimësi.

10.Gjetje nga auditimi:

Domosdoshmëria e marrjes së masave, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët si dhe për shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni kundrejt të tretëve, veprime në kundërshtim me gërmat “g” dhe “gj”, neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Evidentohet një nivel i lartë i detyrimeve të subjekteve debitore dhe klientëve dhe që ka patur trend në rritje për periudhën e audituar. Debitorët e ndryshëm (*llog. 468*) ishin në shumën prej **2,043 milionë lekë** në vitin 2020, **4,209 milionë lekë** në vitin 2021 dhe **4,694 milionë lekë** në fund të v. 2022.

Rezulton se janë shtuar edhe të drejtat e tjera për arkëtim, të tilla si “*Divident i A.P*” për **2,155,452,687 lekë, (për të cilin janë arkëtuar vetëm 1 milionë lekë)**; masa e dëmit sipas urdhrin nr.313. datë 23.12.2020 “Për përfundimet e inspektimit financiar publik” për 7 zyrtarë, me nga 126,322 lekë/secili, etj. *Sa më sipër*, vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 12, pika 3, gërmat “g” dhe “gj”; Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 19 dhe 20 dhe Udhëzimin nr.9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

10. Rekomandimi:

10.1. Drejtuesit e MIE të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë dhe të marrin masat, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët pasi teprica e tyre ka arritur **4,694 milionë lekë** në fund të v.2022 si dhe për shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni kundrejt të tretëve.

10.2. Drejtuesit e MIE të sigurojnë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre, si dhe të propozojnë masa konkrete, duke mos i përjashtuar masat administrative dhe masat e tjera disiplinore nëse është e nevojshme.

10.3. Nga strukturat drejtuese të MIE të rivlerësohen llogaritë e njësisë ekonomike për shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm, pasi të jenë ndjekur më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Afati: Në vijimësi.

11. Gjetje nga auditimi:

1. Nga auditimi i regjistrimit të inventarit të plotë të aktiveve në SIFQ dhe procesin e migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, rezulton se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është pjesë e listës me 4 institucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e aseteve fikse në SIFQ.

2. Mospërputhje e të dhënave të bilancit të vitit paraardhës me bilancin e çeljes së vitit ushtrimor, etj.

1. Nga ana e MIE nuk janë kryer regjistrimet dhe procedurat e migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është pjesë e listës me 4 (katër) institucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e aseteve fikse në SIFQ deri në fund të vitit 2022.

2. Në përfundim të procedurave të kontrolleve kryqëzuese e verifikuese, si dhe kryerjes së testeve thelbësore mbi zërat e Bilancit Kontabël Përmbledhës/ Konsoliduar për MIE, analizuar dy vitet ushtrimore të njëpasnjëshëm 2022 dhe 2021, u konstatua se:

✓ ekzistojnë mospërputhje midis të dhënave të bilancit të mbylljes të vitit 2022 (në formatin 7/b, me ato të regjistruara në Formatin nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, me të dhënat kontabël të bilancit të mbylljes më 31.12.2022 për AAM.

Më konkretisht, *Aktivet Afatgjata Materiale më dt. 31.12.2022 në F1 janë pasqyruar për 182,171,229 mijë lekë dhe në Pasqyrën F7 janë 182,163,506 mijë dhe paraqesin diferencën ose mosrakovimin prej 7,723 mijë lekë.*

Në auditimin e të dhënave të pasqyrës së performancës financiare në PFK të MIE rezulton që totali i të ardhurave gjithsej është i barabartë me shpenzimet plus pjesën e rezultatit, sa sipër kjo, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar. Kështu për vitin 2022, të ardhurat janë 8,108,946 mijë lekë, kurse shpenzimet 8,105,106 mijë lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej 3,839 mijë lekë përfaqëson rezultatit e veprimtarisë vjetore.

Kurse, për vitin 2021, të ardhurat janë 4,911,813 mijë lekë, kurse shpenzimet 4,917,056 mijë lekë dhe teprica e llogarisë 85 në shumën prej -1,321 mijë lekë përfaqëson rezultatit e veprimtarisë vjetore. Nga ana tjetër u verifikua pasqyrimi për të njëjtën shumë i llogarisë 85 “Teprica ose deficieti i periudhës” në pasqyrën nr.1 të pozicionit financiar (rreshti nr.100) dhe në rreshtin nr. 132, të pasqyrës së performancës financiare dhe për këtë vit nuk u konstatuan mospërputhje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

Në fakt, për vitin 2022 shuma e te ardhurave minus shpenzimet jep vlerën prej 3,839,858, (po aq sa pasqyron ne fund të vitit, Pasqyra e Performancës Financiare, kurse evidentohen diferenca për vitin 2021 midis rezultatit të pasqyruar të llogarisë 85 (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve në formatin F2), që nga llogaritjet del 5,242 mijë lekë (4,911,813,705 lekë - 4,917,056,582 lekë); dhe jo -1,321 mijë lekë sa paraqitet vlera ne fund te kësaj tablele. (Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

11. Rekomandimi:

11.1. Nga ana e MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korrigjimin e sistemimit të tyre në pasqyrat financiare të ushtrimit që do të mbyllet më 31.12.2023. Pasqyrat financiare vjetore 2023, të përmbajnë një informacion më të plotë shpjegues, lidhur me pasqyrimin e sistemeve në llogari, pasi konstatohet mungesa e informacionit mbi shpjegimet e nevojshme për mospërputhjet e vlerave në disa llogari të bilancit kontabël.

11.2. Nivelet menaxheriale të MIE të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, dhe të përfundojnë procesin e migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është pjesë e listës me 4 (katër) institucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e aseteve fikse në SIFQ.

Afati: Në vijimësi.

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formatin 12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” është plotësuar, por relacioni shpjegues për pasqyrat financiare nuk ka përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Në lidhje me Formatin “Pyetësor dhe shënime shpjeguese” për pasqyrat financiare, rezulton se në pasqyrat vjetore të institucioneve të varësisë përgjithësisht mungon ky informacion, ose për rastet e hartuara, nuk ka përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë. Sa më sipër, vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

12.1. Rekomandimi:

Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënimet të japin përshkrime dhe zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Afati: Në vijimësi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

13.Gjetje nga auditimi:

Mos rakordim vlerash në bilancin “ushtrimi i mbyllur” (të datës 31.12.2021), me të dhënat e bilancit “ushtrimi paraardhës”, (të datës 31.12.2022), për diferencën prej 4,676,301 lekë.

Konstatohet se, nuk përputhen të dhënat e kolonës “ushtrimi i mbyllur” (i bilancit të datës 31.12.2021, pasqyruar për 391,217,673,910 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, i pasqyruar për 391,212,997,609 lekë), duke rezultuar një diferencë mosrakordimi në vlerën prej - **4,676,301 lekë**. Sa pasqyruar me pak në çelje ushtrimi i mëparshëm, në fillim të vitit 2022, në kundërshtim me paragrafin 31, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se, “Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojë regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar në pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për njësinë publike qendrore ose vendore, që përfshin të gjitha njësitë e varësisë dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

13. Rekomandimi:

13.1.Nga MIE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat për të saktësuar vlerën e diferencave që kanë rezultuar në aktivet dhe pasivet, midis bilancit të mbyllur të vitit të mëparshëm dhe bilancit të çeljes për vitin ushtrimor, dhe mbi këtë bazë të kontabilizohet dhe paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara të MIE për vitin 2023, vlera e drejtë e Aktiveve të Afatgjata Materiale e Jo materiale, të drejtave dhe detyrimeve, etj.

13.2.Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabile në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të MIE, për vitin 2023.

Afati: Në vijimësi.

14.Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022, nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MIE, nuk evidentohet ndonjë rast i regjistruar, ku si pasojë e konstatimit të mosrakordimeve të pasqyrave vjetore të pozicionit financiar (Bilanci) në nivel grupi, t’i jenë kthyer institucionit buxhetor (ose organit qendror të saj), për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, pasi është kontrolluar dhe me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga SIFQ, bazuar në informacionin kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësia qendrore.

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr.8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

14.1. Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për rastet e parregullsive dhe konstatimit të diferencave të paargumentuara, të marrë masat për të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të manualit të klasifikimit ekonomik kontabël, me qëllim për një pasqyrim dhe paraqitje të drejtë të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit si dhe të parandalohen gabimet materiale dhe parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare vjetore.

Afati: Në vijimësi.

15.Gjetje nga auditimi:

Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave.

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve të kaluara në Degën e Thesarit, u evidentua mosrespektimi i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkeluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 184, që ka përcaktuar se: “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, germa “a”, që parashikon se “kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 13-62 të Raportit të Auditimit)

15.1.Rekomandimi:

Nëpunësi Zbatues të marrë masat që të paraqesë në strukturën e Thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorëve ekonomikë, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Afati: Në vijimësi.

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 59, pika i dhe 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë**, që në vlerësim të shkeljeve të konstatuara nga ana e grupit të auditimit, sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, të vlerësojë masën e shkeljeve dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara, sipas nenit 58, shkronja “a”, “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nga “vërejtje”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”; “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”; deri në, “Largim nga shërbimi civil”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

GRUPI I AUDITIMIT

1. Q. C, (përgjegjës grupi),
2. A. Z, anëtar
3. G. G, anëtar,
4. A. M, anëtar.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
Q. C

ANEKSE

LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH MBI AUDITIMIN FINANCIAR³. Auditime financiare⁴, përfshijnë:

1. dhënien e një sigurie të arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi dhe gabimet dhe i mundësojnë audituesit:
 - a. dhënien e një opinionit, nëse pasqyrat janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar;
 - b. dhënien e një opinionit, se mbi pasqyrat financiare, raportohet dhe komunikohet sipas kërkesave të SNA-ve dhe bazuar në gjetjet e auditimit.
2. Dhënia e opinionit shprehet nëpërmjet njërit prej opinionëve të mëposhtme të auditimit⁵:
 - a. **Opinion i Pamodifikuar**⁶, Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ky opinion mund të jetë pa rezervë ose me theksim çështjeje.
Një opinion "Pa rezervë", jepet në rastet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:
 - pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
 - pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
 - janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.*Një opinion me "Theksim Çështjeje"*, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.
 - b. **Opinion i Modifikuar**⁷, jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme

³ -Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH, Tiran 2022.

⁴ INTOSAI, 2019

⁵ IFAC, "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur"

⁶ ISA 700-ISSAI 1700

⁷ ISA 705-ISSAI 1705



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TIRANË

dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënien e opinionin, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultatit financiar.

Ky opinion mund të jetë i kualifikuar/me rezervë, i kundërt ose me refuzim opinionin.

Një “Opinion i kualifikuar/me rezervë”, jepet në rastet kur:

- audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;
- audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Një “Opinion të kundërt”, jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mosrespektimit të cilat janë materiale individualisht ose së bashku janë përhapur në llogaritë vjetore apo transaksionet.

Një “Refuzim opinion”, jepet në rastet kur:

- kur audituesi nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi, mbi të cilat duhet të bazojë mendimin për efektet e mundshme materiale edhe të përhapura mbi llogaritë vjetore apo transaksionet.
- në raste jashtëzakonisht të rralla që përfshijnë pasiguri të shumta, ku audituesi pavarësisht se ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit në lidhje me secilën prej pasigurive, mund të konkludojë se nuk është e mundur për të formuar një opinion dhe në këtë mënyrë refuzon dhënien e tij.